MILLENNIUM CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA

USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

FORCIMI I QEVERISJES NË SHQIPËRI

MBËSHTETJE PËR MARRËVESHJEN PRAG TË LLOGARISË SË SFIDËS SË MIJËVJEÇARIT PËR SHQIPËRINË: RAPORTI PËRFUNDIMTAR

TETOR 2008

Ky raport u përgatit për tu shqyrtuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit. Raporti u përgatit nga Chemonics International Inc.

FORCIMI I QEVERISJES NË SHQIPËRI

MBËSHTETJE PËR MARRËVESHJEN PRAG TË LLOGARISË SË SFIDËS SË MIJËVJEÇARIT PËR SHQIPËRINË: RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Kontratë e USAID Nr. DFD-I-00-05-00219-00, Projekti Nr. 02

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / RUDINA MULLAHI

Besnik Shpata regjistroi biznesin e tij të mjekësisë homeopatike pranë Qendrës së Regjistrimit të Biznesit (QKR). Gjatë vitit të parë të punës në Tiranë dhe në 11 vendndodhjet nëpër bashki, të cilat janë të lidhura në rrjet me njëra-tjetrën, QKR ka përpunuar rreth 93,000 aplikime, duke përfshirë regjistrimin e 19,000 bizneseve të reja.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / RUDINA MULLAHI

Një farmaciste vendos në rafte kutitë e ilaçeve në kompaninë farmaceutike shqiptare, IMI-FARMA. Duke përdorur sistemin e prokurimit elektronik, të zhvilluar nga Projekti i Marrëveshjes së Pragut për Sfidën e Mijëvjeçarit, IMI-FARMA u shpall fituese e një tenderi elektronik të Ministrisë së Shëndetësisë, për ilaçin e quajtur Ribavirin.

PASQYRA E LËNDËS

PËRMBLEDHJE 1

VËSHTRIM HISTORIK RRETH SHQIPËRISË DHE PROJEKTIT 5

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT PËR TRANSPARENCËN 9

POLITIKAT DHE ADMINISTRATA TATIMORE 19

PROKURIMI PUBLIK 29

REGJISTRIMI I BIZNESIT 35

PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE MËSIMET E NXJERRA 41

REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE 47

TABELA RAPORTUESE E REZULTAVE FINALE 50

TREGUES I PËRMBAJTJES SË CD UDHËZUESE 56

FAQJA E PARË: Qendra e regjistrimit të biznesit u krijon mundësinë pronarëve të bizneseve të regjistrojnë bizneset e tyre si për autoritetet ligjore, ashtu edhe për ato tatimore brenda 24 orëve dhe vetëm me anë të një formulari aplikimi, që kushton afërsisht një dollar amerikan. Sistemi i mëparshëm i regjistrimit të bizneseve, i cili administrohej nga 29 gjykata në mbarë Shqipërinë, krijonte mundësi për korrupsion, përmes përdorimit të formularëve shkresorë jo-standartë të aplikimeve, si dhe përmes sistemeve së mbajtjes së të dhënave, që krijonin pengesa për biznesmenët.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / AGIM DOBI

FAQJA E PASME: Pamje e re e Tiranës natën. Qyteti është rritur dhe modernizuar me shpejtësi. Një valë e re ndryshimesh pritet, ndërkohë që investitorët i përgjigjen klimës së re të biznesit dhe qeverisjes, si rrjedhojë e mbështetjes së Projektit të Pragut të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / AGIM DOBI

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / SOKOL KAVALLERJA

Në ndërtesën e re të DPT-së në Tiranë, një qytetare shqiptar përfiton nga shërbimi i modernizuar në Qendrën e Shërbimit të Tatimpaguesit, e cila u dizenjua, mobilua dhe pajis nga projekti. Tashmë, tatimpaguesit mund të aksesojnë llogaritë e tyre përmes kësaj qendre, si një alternativë përveç faqes së internetit të DPT-së, si dhe të përfitojnë një sërë shërbimesh lidhur me informacionin publik, të cilat ofrohen në këtë qendër.

PËRMBLEDHJE

Në prill 2006, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara u angazhuan të bashkëpunojnë për reduktimin e korrupsionit dhe përmirësimin e ecurisë së punës në tre fusha të administratës publike shqiptare nëpërmjet një Plani Prag për Vendin (PPV). Miratuar nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (KSM), Plani parashtroi strategjinë e Shqipërisë për reduktimin e korrupsionit nëpërmjet reformimit të prokurimit publik, administratës tatimore, dhe regjistrimit të biznesit, duke përdorur metodën e "qeverisjes elektronike" për rritjen e transparencës dhe efiçiencës së këtyre shërbimeve.

Në 6 shtator 2006 Chemonics International iu akordua kontrata për zbatimin e Planit Prag për Vendin, një projekt dyvjeçar me vlerë 13,7 milionë dollarë, i administruar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvilim Ndërkombëtar (USAID).

Sot, operacionet e qeverisë, që më parë ishin të vështirë për t'u menaxhuar dhe të mbyllura, janë bërë dukshëm më transparentë dhe eficientë, dhe më pak të korruptuar. Mijra qytetarë dhe biznese shqiptare kanë përfituar nga ndryshimi transformues i ndërveprimeve të tyre të përditëshme me qeverinë, mundësuar nga reforma institucionale e mbështetur me një sërë zgjidhjesh të qeverisjes elektronike.

Dy vjet më parë, regjistrimi i biznesit ishte një proçes i shtrenjtë dhe i ngadaltë që kërkonte dorëzimin në gjykatë të shumë kërkesave dhe shkuarje në zyrat e qeverisë. Sot, regjistrimi kërkon vetëm një aplikim, që përpunohet brenda 24 orësh dhe kushton rreth një dollar amerikan. Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), nga zyra e saj qendrore në Tiranë dhe rrjeti i sporteleve të shërbimit në 11 bashki anembanë Shqipërisë, përpunoi

afërsisht 85,000 kërkesa, dhe regjistroi rreth 18,000 biznese të reja gjatë vitit të parë të veprimtarisë. Publiku mund të përdorë elektronikisht të gjitha të dhënat e regjistrimit të biznesit që gjenden në faqen e internetit të QKR.

Dy vjet më parë, prokurimi publik ishte dukshëm i mbyllur -. Bizneset ishin të detyruar të paguanin për dokumentet e prokurimit dhe të merrnin pjesë në prokurime tashmë të kopsitura pa pasur mundësi ankimimi. Sot, agjencitë e qeverisë qendrore dhe bashkitë i shpallin njoftimet e tenderimit në faqen publike të internetit dhe operatorët ekonomike të interesuar mund të shkarkojnë pa pagesë dokumentet e tenderimit dhe të dorëzojnë ofertat nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik që përmbush standartet e Bashkimit Europian (BE).

Në 9 muajt e parë të vitit 2008, agjencitë qeveritare prokuruan më shumë se US$ 20 milionë për mallra, punime dhe shërbime nëpërmjet më shumë se 50 paketave të veçanta të prokurimit elektronik. Sistemi përmban kontrolle te rrepta -që parandalojnë manipulimin dhe mundësojnë një pikënisje të njëjtë për të gjithë ofertuesit.

Ofertuesit që mendojnë se u janë shkelur të drejtat në një proçes prokurimi, qofte ky elektronik apo me dokumente në letër (jo-elektronik), mund të paraqesin ankime në Zyrën e re të Avokatit të Prokurimeve (ZAP), një agjenci që shqyrton parregullsitë në procedurat e prokurimit publik.

Dy vjet më parë, tatimpaguesit shqiptarë ishin peng i inspektorëve të plotfuqishëm tatimorë, një sjellje e trashëguar nga periudha komuniste, të cilët kishin liri të plotë për të kërkuar e marrë ryshfete në çdo kohë. Sot, shërbimet elektronike dhe reformat administrative po e ndryshojnë administratën tatimore të korruptuar dhe po i transformojnë marrëdhëniet ndërmjet tatimpaguesve dhe qeverisë sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Inspektorët janë xhveshur nga autoriteti i pakufizuar që gëzonin më parë. Aktualisht, përgjegjësitë për përpunimin e praktikave-ndahen ndërmjet njësive administrative sipas linjave funksionale, si për shembull të përpunimit të deklaratave tatimore, kontrolleve, mbledhjes së tatimeve dhe shërbimeve për tatimpaguesit.

Futja e sistemeve elektronike, përfshi formularët tatimorë të shkarkueshëm elektronikisht, deklarimin e tatimeve dhe pagesave në mënyrë elektronike, dhe qasjen elektronike të informacionit të llogarive, u jep mundësi bizneseve tatimpaguesve të ndërmarrin bizneset e tyre në distancë të duhur me administratën dhe duke eliminuar kontaktet personale me zyrtarët tatimorë.

Që nga tetori i vitit 2007, afërsisht gjysma e shoqërive (persona juridikë) dhe tatimpaguesve të vetëpunësuar (persona fizikë) kanë përdorur shërbimet elektronike që ofrohen në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të përfituar sherbime të ndryshme si shkarkimin e formularëve dhe

udhëzimeve tatimore, deklarimin e tatimeve, ose kontrollin e gjendjes së llogarive të tyre tatimore.

Për administrimin e sistemeve të reja të qeverisjes elektronike, qeveria shqiptare krijoi Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI). AKSHI mirëmban dhe koordinon integrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) në të gjitha agjencitë qeveritare. Integrimi mundëson Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) të verifikojë elektronikisht nëse një biznes është i regjistruar si duhet dhe ka paguar në kohë detyrimet tatimore. Projekti ofroi infrastrukturën dhe ndihmë teknike për ndërtimin e kapaciteteve të AKSHI-t, për përmbushjen e detyrave të saj. Krijimi i AKSHI-t është një gur themeli për qeverisjen elektronike që do të ndihmojë për sigurimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të reja të TI-së në Shqipëri.

Në zbatimin e këtyre reformave, stafi i projektit punoi gjerësisht me pesë agjenci homologe shqiptare: Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Agjencinë e Prokurimit Publik, Zyrën e Avokatit të Prokurimeve, Qendrën e Regjistrimit të Biznesit dhe Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit, ndër të cilat tre agjencitë e fundit u krijuan me ndihmën e projektit. Bashkëpunimi ndërmjet stafit të projektit dhe stafit të agjencive homologe rezultoi në një marrëdhënie të frytshme që bëri të mundur arritjet e shumta të projektit.

Një projekt kompleks dhe shumëplanësh kërkon një plan të fortë monitorimi të ecurisë (PME) dhe mjete mbështetëse të krijuara që në hapat e para të projektit. PME-ja e projektit përfshinte treguesit përkatës, të drejtpërdrejtë dhe objektivë për matjen e ndikimit atribuar përpjekjeve të projektit dhe të homologëve në bazë mujore, tremujore, ose vjetore, sipas rastit. Projekti ka mbajtur të dhëna të përditësuara dhe menjëherë të disponueshme për monitorimin e ecurisë, për t'u ofruar homologëve, KSM-së dhe USAID-it një pasqyrë të saktë të ecurisë së projektit. Të dhënat monitoruese të ecurisë janë përdour nga stafi i projektit gjithashtu si instrumenta menaxhues për të identifikuar boshllëqet dhe sukseset. Për të dhënat përfundimtare të raportit të projektit, ju lutemi shihni Shtojce A.

Kapitujt e mëposhtëm në këtë raport shtjellojnë hollësi të mëtejshme rreth metodave dhe përvojës së qeverisjes elektronike në prokurimin publik, administratën tatimore, dhe regjistrimin e biznesit. Raporti përfundon me një përmbledhje të mësimeve të nxjerra dhe rekomandime për të ardhmen e qeverisjes elektronike në Shqipëri.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / EDLIRA KEMBORA

Në datën 19 maj, 2008 Parlamenti miratoi Ligjin për Procedurat Tatimore, i cili hyri në fuqi në datën 25 Qershor. Ligji për Procedurat Tatimore përbën bazën për ndryshimin e klimës së biznesit në Shqipëri, përmes një mënyre të re se si drejtoria tatimore realizon detyrat e saj dhe se si tatimpaguesit i shohin detyrimet e tyre tatimore dhe marrëdhëniet me autoritetet tatimore. Hartimi i këtij legjislacioni kërkoi një vit pune, duke përfshirë këtu një proçes të gjatë negociatash ndërmjet Projektit të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, Ministrisë së Financave, dhe palëve të tjera të përfshira, sesioneve inovative të takimeve publike mbi projektligjin, si dhe opinioneve të dhëna nga komuniteti i biznesit.

KREU NJË

VËSHTRIM HISTORIK RRETH SHQIPËRISË DHE PROJEKTIT

SHQIPËRIA RENDITET NË VENDET E LARTA MES EKONOMIVE NËN REFORMË

Raporti Të Bërit Biznes në Europë dhe Azinë Qendrore për vitin 2009, në listën që klasifikon 113 ekonomi lidhur me treguesit dhe ndikimin e reformave, e rendit Shqipërinë në vendin e dytë ndërmjet 10 reformatorëve më të suksesshëm për vitin 2007-2008.

Renditja e Shqipërisë në vendin e dytë bazohet në përmirësimin e ecurisë në katër fusha, ku përfshihet procedura e fillimit të biznesëve dhe pagesa e tatimeve, dy nga tre fushat kryesore ku u përqëndrua puna e projektit. Shqipëria, në bazë të indeksit të lehtësisë së të bërit biznes, u ngjit nga vendi i 135-të në atë të 86-të.

Në fillim të viteve 90 Shqipëria doli nga izolimi prej më shumë se katër dekadash nën regjimin komunist, mbajti zgjedhjet e para në vitin 1992, hodhi themelet për ekonominë e tregut, dhe u orientua menjëherë drejt integrimit me Organizatën e Traktatit të Amerikës së Veriut (NATO) dhe BE-në. Megjithatë, zhvillimi i Shqipërisë si ekonomi tregu dhe demokraci, dhe aspiratat e saj për integrimin Euro-Atllantik, kanë qënë penguar nga korrupsioni i thellë në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Sipas Bankës Botërore (2008), e cila e rendit Shqipërinë në vendin e 135të nga të178 shtetet ku "biznesi kryhet lehtësisht", kurrupsioni ka vonuar rritjen ekonomike dhe investimet. Korrupsioni gjithashtu ka kompromentuar qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve publike. Sipas Bankës Botërore, procedurat për dhënien e licensave dhe regjistrimin e pasurisë janë të vështira për t'u realizuar dhe të mbushura me korrupsion. Denoncimi këmbëngulës dhe i gjithanshëm nga media i korrupsionit, kombinuar me presionin e ushtruar nga organizatat ndërkombëtare — veçanërisht BE-ja — kanë bërë punën e tyre për të nxitur publikun për të kërkuar reforma dhe ofrimin e shërbimeve publike më efiçiente.

Shqipëria reagoi duke intensifikuar përpjekjet për frenimin e korrupsionit. Reforma kundër korrupsionit ishte tema kryesore e fushatës elektorale të qeverisë aktuale në 2005 dhe u bë shtysë për partneritetin e Shqipërisë me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit (KSM) në 2006. Pas renditjes së Shqipërisë nën mesataren në treguesin "kontrolli i korrupsionit" që shkaktoi moskualifikimin e saj për paketën e ndihmës dypalëshe që

INTERVISTË
Qendra e Re Lehtëson Zhvillimin e Biznesit



PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / KATHY CAMP

Me regjistrimin e biznesit me një ndalesë (one-stop shop), qeveria shqiptare u ka hapur dyert shoqërive për të përfituar nga mundësi të reja.

"Regjistrimi brenda 24 orësh është padyshim një hap në drejtimin e duhur për ta bërë jetën e biznesmenëve më të lehtë," tha Majlinda Hakani, pronare e Hakani Consulting.

"Ishte një nga ato raste urgjente kur klienti kishte nevojë për një vendim sot dhe për raportin dje". Në 10 maj 2008, Majlinda Hakani duhej ta regjistronte biznesin e saj të konsulencës financiare në kohë rekord. Hakani, konsulente që nga mesi i 2007-ës, kishte marrë një ofertë afatshkurtër por klienti mund ta përdorte shërbimin e saj vetëm po ta kishte biznesin të regjistruar ligjërisht.

Falë një fushate të gjerë komunikimi me publikun, Hakani e dinte që regjistrimi i biznesit në Shqipëri ishte transformuar me ndihmën e Marrëveshjes dy vjeçare të Pragut të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, me vlerë 13,85 milionë dollarë. Kjo Marrëveshje – ndërmjet qeverisë së Shqipërisë (QSH) dhe KSM, dhe e administruar nga USAID – ka ndihmuar QSH për reformimin dhe modernizimin e administratës tatimore, procedurave të prokurimit publik dhe të regjistrimit të biznesit nëpërmjet zgjidhjeve të TI dhe përmirësimeve legjislative. Ndërsa më parë regjistrimi i një biznesi zgjaste një muaj a më shumë, tani zgjat vetëm një ditë. Si konsulente korporatash Hakani ishte në dijeni për "kokëdhimbjet, rradhët dhe nervat" që shoqëronin regjistrimin në të kaluarën. "U gëzova kur mësove që USAID e kishte marrë në dorë këtë problem dhe kishte krijuar mundësinë e regjistrimit me një ndalesë (one-stop shop)," tha ajo.

Hakani shkoi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, ku priti rreth pesë minuta për të folur me një nga punonjësit e sportelit, i cili mbushi dokumentacionin e nevojshëm brenda 10 minutash. Pas 24 orësh Hakani shkoi në Qendër për të marrë regjistrimin, që i dha biznesit të saj identitetin ligjor dhe numrin e tatimpaguesit, duke u bërë kështu gati për të pranuar në kohë ofertën e klientit të saj.

Proçesi ishte kaq i shpejtë sa Hakani as që pati kohë për të menduar për problemin që e kishte penguar për ta bërë më parë regjistrimin: emrin e biznesit të saj. "Doja një emër që të përcaktonte një identitet të saktë dhe të përkonte me shërbimin që ofroj" tha ajo. Një shok kishte sugjeruar "Hakani Consulting", duke vënë në dukje që zanoret e shpërndara njëtrajtësisht në mbiemrit të saj do ta bënin shqiptimin e tij të lehtë për klientët e saj nga vende të ndryshme. "Nuk pata kohë dhe alternativë tjetër" tha Hakani. "Po më mësohet veshi me të, dhe gjithsesi jam e kënaqur me emrin".

shoqëron statusin e kompaktit të KSM-së, KSM-ja ra dakort në vitin 2006 për sponsorizimin e Programit Prag të Vendit (PPV) me synimin për të luftuar korrupsionin dhe ndihmuar Shqipërinë për t'u kualifikuar për statusin e kompaktit. KSM-ja përcaktoi një sërë treguesish për matjen e progresit të reformave të PPV-së për reduktimin e korrupsionit, duke u fokusuar në fusha të tilla si regjistrimi i biznesit, deklarimi i tatimeve, dhe prokurimi publik. Kreu i mëposhtëm shtjellon përmirësimin dhe rritjen e transparencës dhe eficiencës në këto fusha si rezultat i sistemeve të qeverisjes elektronike.

PARTNERS ALBANIA/KLOTILDA TAVANI

Për të lehtësuar proçesin e tranzicionit në drejtori të reja funksionale, punonjësit e DPT-së morën pjesë në trajnimin për ankimin tatimor, të organizuar në korrik 2008. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për procedurat tatimore, ekipi i projektit organizoi dhe administroi kurset për zhvillimin e aftësive mbi procedurën e ankimit tatimor dhe procedurave të tjera. Metoda e trajnimit të trajnuesve u përdor për të gjitha sesionet e trajnimit për funksionet tatimore, duke realizuar kështu objektivat e qëndrueshmërisë të projektit.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / AGIM DOBI

Stafi i projektit punon me stafin e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) në sallën e serverit të këtij institucioni. AKSHI u inauguara zyrtarisht në Maj 2008 dhe ceremonia u organizua në zyrat e reja dhe moderne të Agjencisë, të cilat u rinovuan dhe pajisën me mbështetjen e Projektit të Marrëveshjes së Pragut të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë. Ceremonia shërbeu për të shënuar transferimin zyrtar të shërbimeve të qeverisjes elektronike nga projekti që i zhvilloi ato, nën pronësinë e Qeverisë Shqiptare.

KREU DY

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT PËR TRANSPARENCËN

Në vendimin për zbatimin e zgjidhjeve të qeverisjes elektronike, Shqipëria ka ndjekur shembullin e qeverive anembanë Europës dhe botës. Sistemet e qeverisjes elektronike ofrojnë kursim kohe dhe ulje shpenzimesh si për përdoruesit publikë ashtu edhe ata privatë krahas me rritjen e transparencës, llogaridhënies, besueshmërisë dhe qasjes.

Grupi i projektit ka përdorur një përqasje bazuar në internet për krijimin e një sistemi të integruar të qeverisjes elektronike për Shqipërinë. Sistemi lidh agjencitë qeveritare me njëra tjetrën dhe me bizneset, bankat dhe qytetarët, duke lejuar përdorimin publik për shumicën e informacionit dhe përdorim të kufizuar aty kur kërkohet ruajtja e konfidencialitetit. Sistemet e mbrojtjes (firewalls) dhe të ruajtjes (backup) garantojnë ruajtjen e të dhënave, ndërkohë që funksionet e integruara të kontrollit dhe të serverave të kutisë së zezë (black-box server) garantojnë kapjen dhe gjurmimin deri në burim të ndërhyrjeve jolegjitime në të dhëna. Sistemi përdor një platformë interneti Microsoft që është burim i hapur, i pajtueshëm me software të tjerë, dhe i disponueshëm pa liçencë, që ofron mundësinë për ta zgjeruar sistemin në funksione të tjera ekzistuese ose të reja qeveritare. Grupi i projektit e ka projektuar infrastrukturën e sistemit për të përdorur nga më shumë se 200 000 përdorues në orë.

SHËRBIMET ELEKTRONIKE TATIMORE

Sistemi i komunikimit elektronik me tatimpaguesit biznese ofron teknologjinë e nevojshme për eliminimin e kontakteve të shpeshta ndërmjet tatimpaguesve dhe inspektorëve tatimorë, duke reduktuar kështu mundësitë për ofrimin ose kërkimin e ryshfeteve gjatë proçesit të mbledhjes

REZULTATE KRYESORE

- 30,000 tatimpagues biznesi përdorin shërbimet elektronike
- 75,000 formularë janë shkarkuar çdo muaj
- 1,000 deklarata tatimore TVSH-je janë dorëzuan elektronikisht (nga të cilat 15 përqind deklarata tatimore të TVSH-së, 25 përqind deklarata të të ardhurave të TVSH-së)

së tatimeve. Shërbimet kyçe elektronike përfshijnë vënien në dispozicion elektronikisht të formularëve tatimorë, deklarimin elektronik të tatimeve, pagesat elektronike dhe pasqyrat elektronike të llogarive të tatimpaguesve.

Stafi i projektit në punën për hartimin e zgjidhjeve të qeverisjes elektronike për tatimpaguesit biznese, u përball me dy probleme teknike. Së pari, sistemi i TI-së i përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ishte ngritur gjatë një periudhe disavjeçare me një mjedis operues Oracle që kërkon liçenca nga shitësi, të cilat janë të kushtueshme. I njëjti mjedis operues ishte përdorur nga një sërë organizmash të tjera qeveritare në Shqipëri, kështu që qeveria ishte në mëdyshje për të instaluar në DPT një mjedis operues të ndryshëm nga ai ekzistues. Së dyti, sistemi ishte i përbërë nga database të veçantë për çdo zyrë tatimore, pa lidhje ndërmjet zyrave dhe selisë së DPT-së ose ndërmjet DPT-së dhe Thesarit, ku derdhen pagesat e tatimeve. Ky lloj fragmentarizimi i informacionit sfidon përpjekjet për krijimin e një sistemi modern të administratës tatimore me mjete eficiente për zbulimin e shkeljeve dhe për zbatimin e ligjit.

Projekti i dha përparësi krijimit të një sistemi jo të kushtueshëm dhe praktik, i pranueshëm nga DPT-ja dhe lehtësisht i përdorshëm nga tatimpaguesit biznese të të gjitha përmasave, si edhe që mund të përshtatet sipas nevojave të zyrave të rretheve dhe rajoneve. Zgjidhja ishte një sistem bazuar në internet që nuk kërkon pagesa për liçencë. Sofware-i komunikon me database-in e DPT-së nëpërmjet një serveri mbrojtës ose tranzit që konverton formatet e të dhënave. Të dhënat merren çdo ditë nga tatimpaguesit (deklaratat tatimore), Thesari (konfirmimi i pagesave), dhe zyra të tjera tatimore. Tatimpaguesit biznese mund të kontrollojnë llogaritë e tyre duke përdorur një sistem të siguruar identifikimi dhe fjalëkalimi të çertifikuar ndërkombëtarisht dhe në përputhje me praktikat më të mira për transmetimin e të dhënave konfidenciale financiare.

Për zgjidhjen e problemit të fragmentarizimit të të dhënave, stafi riprogramoi routers në zyrat e rretheve për të komunikuar me zyrën kryesore të DPT-së dhe ofroi hardware shtesë për t'i shërbyer rrjetit. Anëtarët e stafit bashkëpunuan me drejtorinë e TI-së të DPT-së për të bërë të mundur shkëmbimet e përditshme automatike të të dhënave rreth pagesave me Thesarin, dhe të të dhënave të regjistrimit të biznesit me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Sistemi tatimor elektronik u krijua hap pas hapi. Një sondazh në vitin 2007 me 300 tatimpagues të mëdhenj konkludoi që 85 përqind kishin përdorim të rregullt të internetit dhe ishin të interesuar për kryerjen e transaksioneve tatimore nëpërmjet internetit. Modulet e deklarimit elektronik të tatimeve dhe të pagesave elektronike u testuan me një grup tatimpaguesish të mëdhenj në Tiranë, që më vonë u përdorën nga 400 biznese me

veprimtari në Tiranë në Zyrën e Tatimpaguesve të Mëdhenj (ZTM). Gjashtë muaj përvojë e tatimpaguesve të ZTM-së në përdorimin e e sistemit krijoi mundësinë për përmirësimin e ndërveprimit të përdoruesit me sistemin kompjuterik dhe për korrigjimin e problemeve të transmetimit të të dhënave të brendshme ndërmjet institucioneve të ndryshme. Hapi tjetër ishte inkurajimi i 7 000 tatimpaguesve të TVSH-së në Zyrën Tatimore Tiranë për deklarimin elektronik të tatimeve dhe për pagesën elektronike tatimore. Ndërkohë, shkarkimi i formularëve tatimorë iu vu në dispozicion të të gjithë tatimpaguesve në Tiranë në fillim të vitit të dytë.

Në sistemin e mëparshëm, tatimpaguesit duhej të takonin inspektorët tatimorë vendorë për marrjen e formularëve tatimorë të cilët ishin shtypur paraprakisht me numrin e identifikimit tatimor të tatimpaguesit, emrin, dhe adresën e tij. Kjo gjë u jepte mundësi inspektorëve tatimorë për të kërkuar "tarifa" shtesë për formularët. Në sistemin e ri tatimpaguesit që preferojnë t'i deklarojnë tatimet me formularë në letër mund t'i shkarkojnë formularët e gatshëm nga faqja e internetit të DPT-së, duke shmangur kështu kontaktet me inspektorin tatimor.

Tatimpaguesit mund, gjithashtu, t'i deklarojnë elektronikisht të

PËRSHTYPJE PËR SISTEMET ELEKTRONIKE

" Është si nata me ditën. Nuk ka të krahasuar. Më parë, duhej të shkoje në zyrën e tatimeve për të marrë formularët. Zyra mund ose mund të mos ishte e hapur Formularët mund ose mund të mos ishin gati. Mund ose mund të mos kishte formularë. Hera herës duhej të shkoje atje më shumë se një herë. Ndërsa sot, une rri para kompjuterit dhe shkarkoj ç'më duhet. Mbush formularët dhe i dërgoj në bankë."

— KONTABILIST KPMG

"Me këtë shërbim të kombinuar – dorëzimi elektronik dhe pagesa elektronike – kursejmë kohë dhe para. Është shumë i volitshëm për ne. Fakti që mund të paguajmë elektronikisht na lejon të ndjekim gjithë pagesat e bëra, dhe nëqoftëse lind ndonjë problem mund të kontrollojmë të gjitha dokumentet në dispozicion. Para dorëzimit elektronik këto probleme na dilnin me administratën tatimore. Më parë, të gjitha dokumentet lidhur me dorëzimin e deklaratave tatimore dhe pagesave përpunoheshin nga administrata, dhe kjo gjë na nxirrte një sërë problemesh. Tani gjërat kanë ndryshuar dhe proçesi është nën kontrollin tonë."

— KOORDINATOR PËR TATIMET DHE DOGANAT

REZULTATE KRYESORE

- Me shume se 500 tatimpagues biznesi u regjistruan si operatorë ekonomikë me SPE
- Me shume se 300 biznese kane derguar oferta elektronikisht
- 58 tendera u kryen elektronikisht në 2008 me nje shume totale prej 23 milion USD (1.8 përqind e tenderave, 5 përqind e buxhetit total të prokurimeve të qeverisë)
- Mesatarisht me shume se 6 oferta për tender

gjitha tatimet kryesore të bizneseve të tyre. Deri tani, me vënien në punë të sistemit të ri, më shumë se 1,600 tatimpagues biznese kanë deklaruar elektronikisht një apo më shume tatime Sistemi i deklarimit elektronik përfshin module për deklaratat mujore për TVSH-në, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat personale të mbajtur në burim, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin vjetor mbi fitimin. Një modul i veçantë i pagesës elektronike tërheq fondet nga llogaria e tatimpaguesit për t'u derdhur në Thesar.

(Shënim: Ky element nuk është vënë akoma në përdorim për shkak të mosmarrëveshjeve teknike ndërmjet DPT-së, bankave dhe Thesarit). Tatimpaguesi merr konfirmim të menjëhershëm për marrjen e deklaratës tatimore nga DPT-ja, dhe për pagesën nga Thesari. Të dy transaksionet pasqyrohen menjëherë në llogarinë përmbledhëse të tatimpaguesit.

Shërbimet e tatimpaguesit janë thelbësore për një sistem vetëvlerësimi. Për forcimin e besimit të publikut në sistemin e deklarimit elektronik të tatimeve dhe të pagesës elektronike, dhe për fuqizimin e tatimpaguesit për mbikëqyrjen e llogarive të tyre tatimore, është tepër e rëndësishme që tatimpaguesit të kenë mundësi t'i shohin menjëherë të gjitha transaksionet, pavarësisht nëse deklaratat tatimore dorëzohen elektronikisht apo në letër. Sistemi i ri pasqyron të gjitha transaksionet debi dhe kredi në përmbledhjen e llogarisë së tatimpaguesit (ose dosjen), të organizuar sipas llojit të tatimeve kryesore.

SISTEMI I PROKURIMIT ELEKTRONIK

Sistemi i prokurimit elektronik (SPE) mundëson një sërë kontrollesh për të siguruar drejtësi dhe llogaridhënie gjatë proçesit të nxjerrjes, dorëzimit dhe vlerësimit të tenderave publik. Ky sistem ofron gjithashtu kursime të konsiderueshme për organet e prokurimit dhe ofertuesit duke eliminuar shtypjen dhe shpërndarjen e dokumenteve të tenderimit, fotokopjimin e dokumenteve mbështetëse, dhe dërgimin e ofertave. Aftësitë raportuese të ndërtuara brenda sistemeve elektronike pakësojnë punën dhe kohën e kërkuar për kryerjen e vlerësimeve të programit të prokurimit.

Brenda një viti stafi i projektit krijoi dhe testoi Sistemin e Prokurimit Publik (SPE) për qeverinë e Shqipërisë, i cili është ndër sistemet më gjithëpërfshirës dhe më të sofistikuar në përdorim nga ndonjë qeveri në botë. SPE-ja përmbush kërkesat e BE-së për prokurimin elektronik, si edhe dispozitat e Ligjit të ri të Prokurimit Publik të Shqipërisë (LPP) që hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2006.

Përdorimi i sistemit të SPE-së kërkon regjistrim paraprak vetëm një herë. Bizneset mund të dorëzojnë oferta tenderimi pas regjistrimit si "operator ekonomik" dhe pajisjes me Identitetin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. SPE-ja është i çertifikuar ndërkombëtarisht dhe përdor procedura sigurimi në përputhje



me praktikat më të mira për transmetimin e të dhënave financiare konfidenciale. Tërheqja e informacionit publik, si shkarkimi i njoftimeve të tenderit dhe dokumenteve të tenderimit, mund të kryhen nga kushdo pa pasur nevojën e fjalëkalimit.

SPE-ja përfshin funksione për procedurat e tenderimit si vijon:

- Procedurë e hapur
- Procedure e kufizuar
- Kërkesë për propozim
- Procedurë për shërbimet konsulencës
- Procedurë blerje me vlerë të vogël

HISTORI SUKSESI
Interneti Transformon Shërbimet Tatimore

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / KATHY CAMP

Një stendë afishimi inkurajon bizneset shqiptare për t'i deklaruar tatimet e tyre elektronikisht dhe – që nga qershori 2008 – rreth 1 500 e kanë bërë këtë gjë.

Para gushtit të vitit 2007, bizneset shqiptare me të ardhura vjetore mbi 8 milionë lekë (100 000 dollarë), para pagimit të tatimeve, duhej të pajiseshin me formularë tatimorë në Zyrën e Tatimeve të Tiranës – disa prej tyre çdo muaj. Për këtë, ata duhej të takonin inspektorin e tyre tatimor, dhe çdo inspektor ishte përgjegjës për rreth 250 shoqëri. Si pasojë, pronarët e bizneseve shpesh duhej të shkonin disa herë në zyrën e tatimeve dhe të prisnin në rradhë të gjata për të marrë formularët. Veç kësaj, inspektorve tatimorë nuk u mbetej kohë për t'u ofruar tatimpaguesve shërbime të tjera përveç shpërndarjes së formularëve, vlerësimit të tatimeve të tyre, dhe firmosjes së dokumenteve tatimore.

Nëpërmjet Projektit të Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, të financuar nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit, qeveria shqiptare dhe USAID-i e kanë ndryshuar situatën tërësisht. Jo vetëm që bizneset tani mund t'i shkarkojnë formularët nga interneti, por që nga prilli 2008, ata mund t'i deklarojnë edhe tatimet në mënyrë elektronike. Jovan Cane, Drejtori i Zyrës së Tatimeve Tiranë, përshkruan ndryshimet dramatike që këto shërbime elektronike u kanë sjellë shqiptarëve. "Para së gjithash, këto shërbime kursejnë kohën e tatimpaguesve. Më parë tatimpaguesit duhej të shkonin në zyra duke harxhuar disa orë, kurse sot mund t'i shkarkojnë formularët për pesë minuta".

Përdorimi i Internetit ka ndryshuar edhe metodën e punës së zyrave të tatimeve. Tani zyrtarët tatimorë kanë kohë t'u përgjigjen kërkesave të klientëve të tyre dhe të shpenzojnë më shumë kohë për t'u ofruar tatimpaguesve shërbime të vlefshme – duke bërë, sipas Canes, "atë që një zyrë tatimesh duhet të bëjë".

"Gjithë këto ndryshime kanë sjellë një mënyrë të re në konceptimin e punës së inspektorit tatimor" thotë Z. Cane. "Tatimpaguesit tashmë janë të shkëputur nga inspektorët tatimorë". Ndërsa vizitat e përmuajshme të tatimpaguesve në zyrën përkatëse të tatimeve u jepnin zyrtarëve të pandershëm mundësinë për të kërkuar ryshfet në këmbim për formularët tatimorë, bizneset që i shkarkojnë elektronikisht formularët e tyre dhe i deklarojnë tatime elektronikisht nuk kanë më kontakte me zyrtarët tatimorë. "Kjo gjë është një arritje shumë e rëndësishme", thotë Z. Cane "sepse është pjesë e luftës kundër korrupsionit".

REZULTATE KRYESORE

- Gjatë vitit të parë të operimit u përpunuan 85,000 kërkesa
- U përpunuan afërsisht 18,000 regjistrime biznesesh të reja (25 përqind rritje në numrin e përgjithshëm të tatimpaguesve biznese aktive)
- 90 përqind e përdoruesve janë të kënaqur
- 95 përqind e komunitetit të biznesit janë të njohur me QKR
- Regjistrimi brenda një dite kryhet në selinë e Qendrës dhe në 11 sportelet e saj anembanë vendit
- Kapacitet për të përpunuar 10 000 kërkesa në muaj
- Përdorim publik të më shumë se 200 000 rekordeve të regjistrimit tregtar

- Procedurë per konkurs projektimi
- Procedurë me negocim me ose pa botim paraprak të njoftimit të kontratës

Kandidatët i ngarkojnë dokumentet dhe i dërgojnë ofertat elektronikisht. Për shmangien e mosrealizimit të dërgimit të dokumenteve të një prokurimi për shkak të ofertave të paplotësuara si duhet, sistemi përmban sinjale paralajmëruese për të vënë në dijeni ofertuesit kur ata nuk i kanë ngarkuar të gjitha dokumentet e kërkuara.

Komisioni i vlerësimit të tenderit i autoritetit kontraktues mblidhet pas mbylljes së tenderit, dhe anëtarët e komisionit futen individualisht në sistem duke përdorur fjalëkalimet e tyre. Ofertat mund të hapen vetëm pas futjes në sistem të të gjithë anëtarëve.

SPE-ja, që aktualisht përdoret nga shumica e autoriteteve kontraktuese të qeverisë qendrore në Shqipëri, është ndërtuar për t'u përdorur edhe nga bashkitë dhe komunat.

QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

Objektivat kryesore të sistemit të ri të regjistrimit janë (i) ulja e kostos dhe e kohës që duhet për regjistrimin e bizneseve të reja ose ndryshimin në regjistrimet ekzistuese, dhe (ii) reduktimi i mundësive për korrupsion.

Më parë, sistemi i regjistrimit tregtar administrohej nga 29 gjykata në të gjithë Shqipërinë duke përdorur një sërë formularë kërkesash në letër dhe sisteme të mbajtjes së të dhënave të pastandardizuara. Pas marrjes së vendimit të gjykatës që miratonte regjistrimin, subjekti duhej të regjistrohej në organet tatimore, organet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe në bashki për taksat vendore. Ligji i ri i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, që u hartua nga grupi i projektit, parashikon zëvendësimin e këtij proçesi me një sistem elektronik të integruar e të standardizuar të përpunimit dhe mbajtjes së të dhënave që bën të mundur proçesin e dorëzimit të kërkesës me një ndalesë dhe miratimin e kërkesës për regjistrim brenda 24 orësh.

Për arritjen e këtij objektivi duhej krijuar infrastruktura dhe sistemet mbështetëse për të bërë të mundur përpunimin e shpejtë dhe të saktë të informacionit të regjistrimit dhe duheshin trainuar punonjësit për përdorimin e këtyre sistemeve. Detyrat që duheshin realizuar përfshinin përgatitjen e legjislacionit për krijimin e QKR-së, përgatitjen e formularëve të standardizuar të regjistrimit të biznesit, projektimin dhe ndërtimin e selise së QKR-së, blerjen e pajisjeve elektronike për ndërtesën kryesore, ngritjen e rrjetit të integruar për sportelet e shërbimit në rrethe, dhe përgatitjen e sofware-it për mbështetjen e 20 funksioneve të regjistrimit individual (p.sh., regjistrimi i një biznesi të ri, anullimi i regjistrimit, rritja e kapitalit, ndryshimi i pronësisë ose i adresës). Pas përgatitjes së sofware-it, stafi i projektit e testoi atë gjerësisht dhe bëri ndryshimet

HARTË: IMPAKTI I PROJEKTIT NË RRITJEN E REGJISTRIMIT TË BIZNESIT



PËRSHTYPJE RRETH SISTEMEVE ELEKTRONIKE

“ Pas hapjes së QKR-së, regjistrimi u bë si llokume drejt e në gojë. Brenda ditës mora në dorë çertifikatën e regjistrimit. E dorëzova kërkesën në orën 9 të mengjesit dhe e mora çertifikatën në orën 2 pasdite.”

— PRONAR BIZNESI, ELBASAN

e nevojshme për përmirësimin e saktësisë së tij dhe të ndërveprimit të përdoruesit me sistemin kompjuterik.

Për realizimin e funksioneve të nevojshme, stafi kapërceu një sërë vështirësish gjatë zbatimit. Njëra prej tyre ishte lidhja e sistemit të ri të regjistrimit të QKR-së me sistemet e të dhënave elektronike në organet tatimore dhe agjencitë e tjera të regjistrimit për përditësimin e përditshëm të informacionit në këto agjenci. Një vështirësi tjetër ishte transferimi, automatizimi dhe integrimi i të dhënave ekzistuese të regjistrimit, që datonin që nga viti 1991 – më shumë se 1 milion faqe dokumentash në letër, disa prej të cilave ishin të dëmtuara.

Në shtator të vitit 2008 sistemi mbushi një vit funksionimi të suksesshëm, në ndihmë të nxitjes së investimeve dhe të rritjes së ekonomisë duke ofruar regjistrimin e biznesit me një ndalesë brenda 24 orëve.

AGJENCIA KOMBËTARE PËR SHOQËRINË E INFORMACIONIT

Zbatimi i një sistemi të zgjeruar e kompleks të qeverisjes elektronike brenda një harku kohor dy vjeçar kishte nevojë për një mekanizëm për garantimin e vazhdimësisë së tij. Ky mekanizëm u krijua në prill të vitit 2007 me vendimin e Këshillit te Ministrave për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), që ka për detyrë koordinimin dhe nxitjen e zgjidhjeve të qeverisjes elektronike në Shqipëri.

USAID-i ofroi infrastrukturën dhe ndihmën teknike për AKSHI-n dhe, në bazë të një marrëveshjeje transferimi, ia dorëzoi AKSHI-t kontrollin operacional të qendrës së shërbimeve të qeverisjes elektronike. AKSHI do të mbështesë regjistrimin elektronik, prokurimin elektronik, dhe tatimin elektronik dhe do të zhvillojë shërbime shtesë në ndihmë të bizneseve dhe të publikut.

Për të ndihmuar këtë agjenci të sapokrijuar për marrjen sa më shpejt mbi vete të përgjegjësive, stafi rinovoi zyrën e AKSHI-t, bleu pajisje kompjuterike për ekspertët e TI-së, dhe prokuroi servera për sistemimin e portalit të qeverisjes elektronike në një mjedis të standarteve të larta të funksionimit dhe sigurisë.

PARTNERS ALBANIA / KLOTILDA TAVANI

Ekipi i projektit administroi trajnimin e trajnuesve të DPT-së mbi procedurat e kontrollit tatimor, në pajtim me ligjin e ri për procedurat tatimore, që hyri në fuqi në maj 2008. Gjithashtu, ekipi organizoi kurse për zhvillimin e aftësive mbi mbledhjen e tatimeve, ankimin tatimor dhe shërbimin për tatimpaguesit. Metoda e trajnimit të trajnuesve u përdor të gjitha sesionet e trajnimit për funksionet tatimore, duke realizuar kështu objektivat e qëndrueshmërisë të projektit.

KREU TRE

POLITIKAT DHE ADMINISTRATA TATIMORE

Sondazhet e organizuara gjatë dekadës së fundit nga organizatat ndërkombëtare e kanë renditur administratën tatimore të Shqipërisë ndërmjet organizatave qeveritare më të korruptuara. Për ndryshimin e këtij imazhi, një nga synimet e PPV-së ishte të zëvendësonte marrëdhëniet e ngushta, ndonjëherë imponuese, ndërmjet inspektorëve tatimorë dhe tatimpaguesve të biznesit, që shpesh rezultonin në ryshfete, zhvatje dhe trajtim të pabarabartë të tatimpaguesve.

Sistemi i reformuar i administratës tatimore kishte për qëllim futjen e praktikave më të mira ndërkombëtare bazuar në parimet e vetëvlerësimit, dhe përdorimin e parimit të kontrollit dhe balancimit që mbështet administratën moderne tatimore.

Trajtimi i drejtë dhe i barabartë i tatimpaguesve në sistemin e ri do të lejonte si rezultat administratën tatimore për të projektuar një imazh që do të frymëzonte konfidencën dhe besimin e publikut, dhe do të kontribuonte në respektimin e ligjit nga ana e tatimpaguesve.

Reforma gjithëpërfshirëse e administratës tatimore zakonisht zgjat 5 deri në 10 vjet. Për shkak të përmasave dhe kompleksitetit të DPT-së – 36 zyra rajonale dhe më shumë se 1 500 punonjës – reforma e administratës tatimore filloi me projektin pilot në Zyrën e Tatimpaguesve të Mëdhenj (ZTM), një zyrë që shërben për tatimpaguesit e biznesit me të ardhura më të larta se një shumë e caktuar, dhe nga Zyra e Tatimeve të Tiranës (ZTT), që u shërben tatimpaguesve me bazë në Tiranë.

Burimet e projektit u përdorën për përmirësimin e shërbimeve për këto dy grupe tatimpa-

INTERVISTË

Shërbimet Elektronike Zbusin Frikën nga Korrupsioni

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / KATHY CAMP

Për Viola Puçin, e cila punon me një agjenci qeveritare për nxitjen e investimeve, pas hapjes së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në shtator 2007, po bëhet gjithnjë e më e thjeshtë për t'i bindur bizneset e huaja për të ardhur në Shqipëri.

Viola Puçi është rritur në Kanada por u kthye në Shqipëri për të vënë në praktikë njohuritë që mori në shkollë lidhur me rrugët se "si një vend mund të ndryshohet nëpërmjet reformave". Ajo punon në Albinvest, një organizatë qeveritare që nxit investimet e huaja në Shqipëri. Aktualisht, puna e saj po lehtësohet gjithnjë e më shumë si rezultat i reformave të qeverisjes elektronike të zbatuara nga qeveria shqiptare dhe USAID nëpërmjet Projektit të Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit, që po hedhin themelet e ndryshimeve ekonomike pozitive që ajo i ka studiuar në shkollë.

Sipas Violës, korrupsioni është një nga shqetësimet më të shpeshta të ngritura në bisedat me biznese që synojnë të investojnë në Shqipëri. Megjithatë, me futjen në Shqipëri të shërbimeve të reja të qeverisjes elektronike – deklarimi elektronik i tatimeve kryesore të biznesit, prokurimi elektronik për disa kontrata qeveritare, regjistrimi i biznesit me një ndalesë (one-stop shop) dhe shërbime të tjera në Internet – sipas Violës, po bëhet gjithnjë e më e thjeshtë për t'iu përgjigjur shqetësimeve të biznesit të huaj.

"Një nga gjerat e para që frenon bizneset për të ardhur në rajon është korrupsioni. Ne u shpjegojmë atyre që aktualisht ka shumë procedura, si prokurimi dhe pagesa e tatimeve, që nuk bëhen më nëpërmjet kontakteve me punonjësit por në mënyrë elektronike. Dhe kjo gjë e ndryshon realisht perceptimin e tyre (për Shqipërinë), dhe ata duan të mësojnë më shumë".

Viola thotë se para krijimit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) si sporteli i vetëm i regjistrimit, bizneset e huaja kishin frikë, gjithashtu, që proçesi i zgjatur i regjistrimit mund të krijonte mundësinë që zyrtarët përgjegjës të kërkonin ryshfet. Më parë, për të bërë një regjistrim duhej të trokisje në shumë zyra qeveritare dhe shpesh procedura zgjaste rreth 50 ditë. Sot proçesi i modernizuar zgjat vetëm një ditë dhe është përgëzuar nga biznese të huaja si Colliers International, një shoqëri pasurish të paluajtshme që së fundi ka hapur një degë në Tiranë.

"Ky ishte regjistrimi me më pak koklavitje gjatë 15 vjetëve që po punojmë në rajon", thotë Philip Bay, Drejtori i Përgjithshëm i Coliers International Albania. "Ajo që vihet re nga cilido që hyn në [QKR] është fryma e transparencës dhe ndershmërisë. Nuk ka pengesa, dhe kjo është një gjë shumë e rëndësishme".

REZULTATE KRYESORE

- Legjislacioni i ri në fuqi, është modern, gjithëpërfshirës dhe plotësisht në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare
- Përcaktimi dhe fuqizimi i të drejtave të tatimpaguesve
- Krijimi i autoritetit për riorganizimin funksional të administratës tatimore në tërësi dhe për deklarimin elektronik të tatimeve
- Pajisja e DPT-së me kompetenca për zbatimin e masave shtrënguese në përputhje të plotë me praktikat më të mira ndërkombëtare, dhe reduktimi i rolit të policisë tatimore
- Fuqizimi i parimeve të vetëvlerësimit Ndryshimi i plotë i regjimit të gjobave
- Krijimi i autoritetit për kontrollet selektive në bazë rreziku, duke zëvendësuan proçesin i vjetër të verifikimit të librave dhe regjistrimeve tatimore në mbështetje të pagesave mujore të TVSH-së
- Krijimi i sistemit dy-shkallësh të ankimit tatimor

guesish që përbëjnë afërsisht 80 përqind të të ardhurave të tatimeve të biznesit.

REFORMA LIGJORE DHE RREGULLATORE: LIGJI I PROCEDURAVE TATIMORE

Në bazë të një analize të akteve ligjore dhe nënligjore tatimore që u krye në muajt e parë të projektit, stafi propozoi të ndihmonte Ministrinë e Financave për hartimin e një ligji të ri të unifikuar të procedurave tatimore që do të zëvendësonte ligjin ekzistues të miratuar në vitin 1999, i cili nuk pasqyronte praktikat më të mira ndërkombëtare në administrimin e tatimeve.

Qëllimi ishte adresimi i mungesave të ligjit të vjetër dhe transformimi rrënjësor i administratës tatimore. Në fillim të prillit 2007, grupi ofroi ndihmë teknike një vjeçare për organizimin e grupit të punës për legjislacionin tatimor, për studimin e praktikave më të mira, për hartimin e ligjit të ri, përgatitjen e dokumenteve shpjeguese dhe paraqitjen e materialeve, dhe organizimin e diskutimeve me publikun.

Kuvendi miratoi ligjin e ri të procedurave tatimore në maj 2008, dhe Presidenti e dekretoi ligjin në qershor 2008. Përgëzuar nga kryeministri i Shqipërisë si "kushtetuta e administratës tatimore" dhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar si "guri i themelit për një sistem tatimor të nivelit botëror", ligji parashikon qartësisht dhe shprehimisht një sërë të drejtash dhe përgjegjësish të tatimpaguesit, mjetet shtrënguese të përmirësuara, organizimin e administratës tatimore sipas funksioneve, fuqizimin e burimeve njerëzore, autoritetin për deklarimin elektronik të tatimeve, proçesin e ankimit tatimor, që është në përputhje me standartet ndërkombëtare, dhe shumë elementë të tjerë që fuqizojnë qeverinë për mbledhjen e të ardhurave tatimore ndërkohë që u mundëson tatimpaguesve nje proçes të drejtë dhe të rregullt.

Stafi, pas hyrjes në fuqi të ligjit, ndihmoi në hartimin e projekt rregulloreve për zbatimin e dispozitave dhe krijoi manualët për funksionet kyçe të administratës tatimore. Rregulloret, të miratuara në gusht 2008, përfshijnë procedurat e reja për kontrollet, mbledhjen, pagesat e gjobave, ankimet, dhe proçese të tjera kyçe.

Për eliminimin e proçesit të verifikimit për te gjithë tatimpaguesit e TVSH-së, ligji e procedurave tatimore autorizoi përdorimin e një sistemi kontrollit me zgjedhje bazuar në analizën e rrezikut, dhe projekti bashkëpunoi me DPT-në që të ndërtonte dhe zbatonte një sistemi të përshtatshëm kontrolli me zgjedhje. Sistemi i ri i kontrolli me zgjedhje është objektiv, bazuar në kritere të qarta dhe transparente, dhe më praktik.

Sistemi identifikon deklarimet tatimore që kanë probabilitet të lartë për tatime të paraportuara dhe mund të ofrojë të ardhura shtesë që i kalojnë kostot e vetë proçesit të kontrollit. Ky sistem

u testua në kontrolle të reja në ZTT dhe ZTM, dhe, në gusht, në 13 zyra të tjera.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Vënia në zbatim e reformës tatimore kërkon si ristrukturim institucional ashtu edhe trainim gjithëpërfshirës. Paralelisht me progresin e ligjit në proçesin legjislativ, stafi i projektit filloi marrjen e një sërë masash për fuqizimin institucional të DPT-së.

Fillimisht, stafi u përqëndrua në zhvillimin e infrastrukturës për mbështetjen e shërbimeve elektronike të përshkruara në Kreun II. Krahas kësaj, stafi pajisi dhe mobiloi Qendrën moderne të Shërbimeve për Tatimpaguesin në ndërtesën e re të DPT-së në Tiranë. Tatimpaguesit mund të shkojnë në këtë qendër për të parë llogaritë e tyre nëse nuk zgjedhin që t'i shohin llogaritë e tyre në faqen e internetit.

Qendra ofron një sërë shërbimesh informacioni publik dhe një mjedis të kontrolluar për mbledhje me zyrtarët tatimorë lidhur me raste të ndryshme tatimore. Duke parë dobinë e qendrës, DPT-ja ka rënë dakort për të hapur qendra të ngjashme në të gjitha degët rajonale të tatimeve.

Stafi përmirësoi gjithashtu serverat, ruters dhe swichet, mjetet/paisjet e ruajtjes, instalimet, dhe furnizim alternativ me energji në departamentin e TI-së në DPT. Për t'u ardhur në ndihmë punonjësve të DPT-së për krijimin e një sistemi vërtet të integruar të administratës tatimore, stafi ofroi asistencë teknike për riprogramimin e routers në 10 zyra të rretheve për të vendosur lidhjen me selinë e DPT-së.

Stafi përgatiti software-in e ri për mbështetjen e përpunimit të rasteve kryesore dhe funksionet menaxheriale të drejtorive. Modulet përfshinë menaxhimin e rasteve dhe menaxhimin e marrëdhënieve me klientin për Qendrën e Shërbimeve të Tatimpaguesit, software-in për analizën e rrezikut për zgjedhjen e rasteve të kontrollit, dhe një paketë raportesh të standardizuara për drejtuesit më të lartë të DPT-së.

Për mbështetjen e riorganizimit të DPT-së sipas funksioneve, stafi ndërmori disa iniciativa kryesore. Projekti përgatiti një plan riorganizimi, i cili u miratua në gusht 2008 me urdhër ekzekutiv të Kryeministrit. Kjo iniciativë gjithëpërfshirëse sjell ndryshime rrënjësore në synimin e agjencisë për përcaktimin e proçeseve dhe modelin e vendimit të menaxhimit duke futur njëkohësisht kontrollet dhe balancat strukturore të hartuara me kujdes që nxisin transparencën.

Stafi vlerësoi edhe nevojat për puno-njës, përgatiti përshkrimet e punës, dhe përcaktoi kualifikimet e kërkuara për çdo pozitë. Një sondazh për aftësitë profesionale i organizuar me disa qindra punonjës të ZTT-së dhe

“ Miratimi i ligjit të procedurave tatimore përfaqëson një revolucion në marrëdhëniet ndërmjet tatimpaguesve dhe administratës tatimore. Tani të drejtat dhe përgjegjësitë janë përcaktuar qartë, sistemi është modernizuar, shërbimet janë thjeshtuar si rezultat i komunikimeve elektronike, dhe kontaktet ndërmjet tatimpaguesve dhe zyrtarëve tatimorë janë minimizuar. Kjo është një arritje vërtet e madhe.”

— PROF. GJOKË ULDEDAJ, KRYETARI I DHOMËS SË TREGTISË DHE INDUSTRISË, TIRANË

ZTM-së identifikoi nevojat për trainim dhe dha informacion të çmuar për kryerjen e lëvizjeve të punonjësve në pozita të ndryshme.

Për punonjësit e DPT-së u organizuan një sërë trainimesh. Punonjësit e Qendrës së Shërbimeve të Tatimpaguesit dhe të ZTM-së morën pjesë në një kurs dyditor për marrëdhëniet me publikun. Ky trainim u pasua nga trainimi i inspektorëve tatimorë për përdorimin e software-it të deklarimit elektronik të tatimeve.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të procedurave tatimore, stafi përgatiti për punonjësit e DPT-së materiale trainimi për ti orjentuar në lidhje me dispozitat kryesore të ligjit të ri, si edhe kurse aftësimi profesional për departamentet e reja të organizuar në bazë funksioni (kontrolli, mbledhja, ankimi tatimor, dhe shërbimet për tatimpaguesit). Ekspertët e projektit dhe specialistët e DPT-së udhëzuan trainerët, të cilet më pas trainuan afërsisht 1 000 punonjës të DPT-së duke përdorur materialet trainuese të përgatitura nga projekti.

INFORMIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT: DEKLARIMI ELEKTRONIK I TATIMEVE

Suksesi i reformës tatimore varet nga menaxhimi kompetent i komunikimit me publikun dhe komunitetin e biznesit. Stafi i projektit ndërmori tre iniciativa kryesore për informimin e publikut për mbështetjen e reformës së administratës tatimore.

Gjatë fundit të vitit 2007, stafi bashkëpunoi me Ministrinë e Financave për organizimin e diskutimeve të zgjeruara publike me shoqatat dhe përfaqësuesit e biznesit për tërheqjen e mendimeve të tyre lidhur me projekt ligjin e procedurave tatimore, i cili ishte botuar edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave. Kjo ishte hera e parë që Ministria e Financave organizonte konsultime të gjera publike për projekt-ligjet fiskale.

Stafi analizoi komentet e nxjerra nga diskutimet dhe komentet e marra me shkrim dhe propozoi ndryshime për korrigjimin e mangësive në projekt-ligj.

Në fillim të marsit 2008, stafi ndërmori një fushatë multimediale për paraqitjen para tatimpaguesve të vegjël dhe të mesëm të shërbimeve elektronike të tatimeve. Fushata konsistoi në korrespondencën e drejtpërdrejtë me tatimpaguesit e TVSH-së dhe reklama të botuara në tre gazetat me të mëdha në Tiranë, pasuar nga reklama në radio dhe reklama në mjedise të hapura.

Në periudhën prill-qershor 2008, stafi organizoi trainimin e më shumë se 1 000 kontabilistëve të pavarur dhe të shoqërive për përdorimin e software-it të deklarimit elektronik të tatimeve. Në një kurs trainimi dyorësh në një nga laboratorët kompjuterikë në Tiranë, pjesëmarrësit u njohën dhe përdorën software-in të lidhur në internet në kohë reale.

Përpjekja e fundit për informimin e publikut u fokusua në kri-

HISTORI SUKSESI

Ofertimi elektronik: Një klikim drejt shpalljes fitues



PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / RUDINA MULLAHI

Për Artan Isarajin e Alba Medic sh.p.k., të përdorësh sistemin e prokurimit elektronik do të thotë të sigurosh përfitimin maksimal nga mundësitë që jepen për të siguruar kontrata nga institucionet publike me një kosto më të ulët.

"Mjafton të dish të shtypësh në kompjuter e të klikosh, plus të dish NIPT-in dhe fjalëkalimin tënd." Ja ç'duhet sipas Artan Isarajit, manager për marketingun dhe logjistikën tek Alba Medic sh.p.k., për të përdorur Sistemin e ri të Prokurimit Elektronik (SPE), një nga sistemet e qeverisjes elektronike të vëna në funksionim nga Projekti Prag i Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë.

Për Alba Medic, një kompani farmaceutike e regjistruar në vitin 2003, mesatarisht 60 deri në 70 për qind e xhiros realizohet nga kontratat me institucionet publike. SPE po ndikon mjaft pozitivisht në fitimet e saj. Sipas Artanit, me pak fjalë, "Ofertimi elektronik është i leverdishëm".

Para këtyre reformave, qasja e bizneseve si Alba Medic në fushën e prokurimit publik ishte e kufizuar. Proçesi nuk garantonte konkurim të ndershëm. Me futjen e teknologjisë së informacionit dhe ndryshimet e rendësishme në legjislacion, sistemi i prokurimit publik në Shqipëri i ka krijuar mundësinë si Alba Medic ashtu dhe një numri në rritje biznesesh në Shqipëri që të marrin pjesë dhe fitojnë kontrata të mëdha e të vogla publike pa u detyruar të përballojnë shpenzime që tradicionalisht duheshin bërë në këto raste. "Ne mund të përdorim, dokumentet e noterizuara, të cilat kushtojnë jo pak, disa herë për oferta të ndryshme. Koha e përgatitjes së tyre është përgjysmuar dhe s'ka më nevojë t'i çosh dokumentet dorazi", sqaron Artani. "Për më tepër që kur përdor SPE-në, kam garanci që dokumentet që kam dorëzuar, nuk zhduken."

Me rritjen e integritetit të proçesit të prokurimit publik, më shumë kompani po marrin pjesë në tenderat elektronikë. Në fakt numri i operatorëve që ofertojnë mesatarisht në tenderat elektronikë (6 për tender) është mbi dy herë më i madh se ai në prokurimet me letër (2.5 për tender). Rritja e konkurencës ka ulur koston e mallrave dhe shërbimeve për qeverinë shqiptare, e cila synon të promovojë një mjedis më dinamik dhe të begatë për biznesin në Shqipëri.

Përsa i përket Alba Medic, ata kanë fituar 24 tendera këtë vit dhe janë optimistë. Duke buzëqeshur Artani pranon se "po të pyesni konkurentët tanë, ata do t'ju thonë se ne jemi ofertuesit e rinj në prokurimet publike. Ne, nga ana jonë, shohim punën."

jimin e imazhit të një DPT-je të re dhe njohjen e tatimpaguesve me ndryshimet e rëndësishme në legjislacion.

Një reklamë televizive theksoi angazhimin e qeverisë për transparencë dhe trajtim të drejtë dhe të barabartë të të gjithë tatimpaguesve, ndërsa u shkruan artikuj, broshura, dhe njoftime në faqen e internetit që nënvizuan zgjerimin e të drejtave të të gjithë tatimpaguesve, ndryshimet në procedurat kryesore, dhe përmirësimet në administratën tatimore dhe masat shtrënguese.

REZULTATET E MBËSHTETJES SË POLITIKËS TATIMORE

Ndikimi pozitiv i përmirësimeve të administratës tatimore të mbështetur nga projekti do të ndihet i plotë pas përfundimit të projektit në formën e përmirësimit të zbatimit të ligjit. Megjithatë, disa përfitime janë tashmë të matshme.

Që nga fillimi i punës së projektit deri në shtator 2008, numri i tatimpaguesve biznese të regjistruar u rrit më shumë se 25 përqind 3.2 miliard lekë, apo afërsisht 37 milion USD, janë paguar në formën e taksave nga më shumë se 18,000 biznese të reja të regjistruara gjatë periudhës shtator 2007 – shtator 2008.

Kjo e dhënë nuk përfshin taksat e paguara nga bizneset e vogla (biznese me xhiro vjetore më pak se 8 milion lekë apo afërsisht 100,000 USD, të cilat nuk paguajnë TVSH apo tatim mbi fitimin tek organet e qeverisjes qendrore por paguajnë një taksë të vogël për biznesin tek organet e qeverisjes vendore).

Numri i deklarimeve mujore tatimore për seicilën nga tatimet kryesore të biznesit u rrit me 15 përqind gjatë periudhes Janar-Qershor 2008 në krahasim me periudhën Janar-Qershor 2007 Të ardhurat nga tatimet e biznesit (të mbledhura nga qeveria qendrore dhe bashkitë) u rrit me 16,9 përqind gjatë së njëjtës periudhë megjithë uljen në 1 korrik 2007 të shkallëve më të larta të tatimit mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale.

Megjithëse një pjesë e të ardhurave shtesë ka ardhur si rezultat i rritjes reale të PBB (produkti i brendshëm bruto) dhe inflacionit, është me vend të thuhet që pjesa tjetër e të ardhurave shtesë i atribuohet taskave të bizneseve të reja të regjistruara si dhe përmirësimeve në zbatimin e ligjit nga ana e bizneseve ekzistuese.

Projekti kontraktoi një organizate vendase për të kryer dy sondazhe të mëdha nëpërmjet intervistimit direkt të biznesve në Shqipëri rreth çështjeve të mbuluara nga të tre komponentet e projektit.

Sondazhi rreth Nevojave të Biznesit u realizua në korrik 2007 dhe u pasua nga Sondazhi mbi Impaktin e Projektit në korrik 2008. Në vitin 2007, 49 përqind e të intervistuarve identifikuan "vizitat në zyrën e tatimeve" si burimin kryesor të informacionit lidhur me sistemin tatimor, dhe vetëm 11 përqind

Stafi i Projektit të Marrëveshjes së Pragut të Sfidës së Mjëvjeçarit për Shqipërinë punon me stafin TI të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) për të testuar sistemin e prokurimit elektronik (SPE), në sallën e serverit të APP. Menjëherë pas miratimit përfundimtar, ekipi i projektit dhe stafi i APP-së bashkëpunuan për të trajnuar më shumë se 800 zyrtarë të prokurimit lidhur me përdorimin e SPE.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / AGIM DOBI

identifikuan "faqen e internetit të Drejtorisë së Tatimeve".

Sipas sondazhit të kryer gjatë 2008, 55 përqind e bizneseve të mëdha të intervistuara identifikuan "faqen e internetit të Drejtorisë së Tatimeve" si burimin kryesor të informacionit lidhur me sistemin tatimor. duke treguar një rritje shumë të ndjeshme në numrin e tatimpaguesve që përdorin faqen e internetit të DPT-së si burim informacioni tatimor.

70 përqind e bizneseve e vlerësojnë cilësinë e faqes së internetit të DPT-së si "të mirë" ose "shumë të mirë", ndjekur nga 24 përqind e bizneseve që e vlerësojnë atë si faqe interneti me cilësi mesatare. Për t'u shënuar, megjithatë, është që bizneset që veprojnë jashtë Tiranës vazhdojnë të mbështeten kryesisht në vizitat në zyrat e tatimeve për marrjen e informacionit tatimor.

Krahasuar me vitin 2007, ka një rritje të ndjeshme prej 14 përqind në përdorimin e shërbimeve bankare në internet nga bizneset që veprojnë jashtë Tiranës, dhe gjithashtu një përmirësim në të gjitha aspektet lidhur me marrëdhëniet e bizneseve me sistemin tatimor gjatë 2008, krahasuar me sondazhin e vitit 2007.

Ndërmjet të intervistuarve tatimpagues të mëdhenj, 68% e tyre e vlerësuan trajtimin në përgjithësi si "Shumë të Mirë" ose "Të Mirë" në sondazhin e realizuar në vitin 2008, krahasuar me 45% në sondazhin e realizuar në vitit 2007, pra me një përmirësim prej 25%. Në mënyrë të ngjashme, përqindja e përgjigjes "Shumë Mirë" ose "Mirë" lidhur me cilësinë e informacionit është rritur nga 36% në 53%.; ndërsa, përsa i përket disponueshmërisë së informacionit, rritja rezulton nga 37 % në 52%.

Në përgatitjen dhe dorëzimin e deklaratave tatimore mujore, 58 përqind e bizneseve të intervistuar në sondazh thanë që, mesatarisht, punonjësit e tyre shpenzojnë më pak se një ditë për përgatitjen dhe dorëzimin e deklaratave tatimore mujore. 54 përqind e tatimpaguesve të mëdhenj të intervistuar thanë që i përgatisnin dhe i dorëzonin deklaratat e tyre tatimore mujore në më pak se një ditë ndërkohë që në vitin 2007 ky tregues ishte vetëm 24% të të intervistuarve.

Ndoshta më e rëndësishme është që 81 përqind e bizneseve të intervistuar thanë që kurrë nuk kanë dhënë dhurata lidhur me tatimet dhe mbledhjen e tatimeve.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / ENI GJINAJ

Dy punonjëse të komponentit të prokurimit publik të projektit marrin CD udhëzues për Sistemin e Prokurimit Elektronik, të zhvilluar nga Projekti i Marrëveshjes së Pragut për Sfidën e Mijëvjeçarit. Gjatë vitit të parë të projektit, ekipi i tij trajnoi stafin e APP-së dhe punoi me ta për të udhëzuar më shumë se 800 zyrtarë të prokurimit në të gjithë Shqipërinë mbi tiparet dhe procedurat e ligjit të ri për prokurimet.

KREU KATËR

PROKURIMI PUBLIK

Vlera vjetore e prokurimeve publike në Shqipëri arrin afërsisht 1,3 miliard dollarë, ose përbën një të tretën e shpenzimeve publike. Nga kjo shumë, afërsisht 90 përqind prokurohet nëpërmjet buxheteve të agjencive të qeverisë qëndrore dhe shoqërive pronë shtetërore, kryesisht Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH), dhe pjesa tjetër prokurohet nëpërmjet buxheteve të bashkive dhe komunave. Në total, ka më shumë se 2 000 autoritete kontraktuese dhe 6 000 zyrtarë prokurimi, shumë prej të cilëve punojnë për prokurimet me kohë të reduktuar. Çdo vit përpunohen 7 000 - 8 000 prokurime.

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR: LIGJI I RI I PROKURIMIT PUBLIK

Kur filloi projekti, një program i financuar nga BE-ja, i quajtur Mbështetje për Sistemin e Prokurimit Publik (MSPP), ishte duke përfunduar një draft i projekt ligjit të prokurimit publik (LPP) që përcaktonte parimet, procedurat, dhe kontrollet në konformitet me standartet e BE-së. Stafi i projektit u dha ndihmë teknike komisioneve parlamentare përkatëse gjatë diskutimeve të projekt ligjit, dhe Kuvendi ra dakort të shtonte në ligj dispozitat për autorizimin e prokurimit elektronik. Stafi gjithashtu mbështeti Kuvendin për diskutimin e dispozitave për krijimin e Zyrës së Avokatit të Prokurimeve. Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të prokurimit publik, stafi ndihmoi në përgatitjen e akteve nënligjore dhe dokumenteve standarte të tenderimit të kërkuara për zbatim.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE: AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Agjencia e Prokurimit Publik (APP), autoriteti mbikëqyrës dhe

trainues për të gjitha prokurimet e organeve të qeverisë qendrore dhe vendore, që në fillim ka qënë një partner i rëndësishëm i projektit. Gjatë vitit të parë stafi i projektit trainoi stafin e APP-së dhe bashkëpunoi me stafin e APP-së për orientimin e më shumë se 800 zyrtarëve të prokurimit anembanë Shqipërisë lidhur me dispozitat e ligjit të ri të procedurave të prokurimit.

Stafi ndihmoi për përmirësimin e faqes së internetit të APP-së për të mundësuar shkarkimin dhe dërgimin e dokumenteve të tenderimit për të gjitha prokurimet.

Si rezultat, kandidatët nuk kanë më nevojë të blejnë dokumente të shtypura të prokurimit, të cilat mund t'i shkarkojnë pa pagesë nga interneti. Vetëm ky ndryshim ka rezultuar në rritje të ndjeshme në pjesëmarrjen e shoqërive në proçesin e prokurimit publik – veçanërisht nga shoqëri të vogla dhe në pronësi të grave që më parë nuk ishin në gjendje të përballonin shpenzimet e tenderit.

Për mbështetjen e APP-së për përdorimin e sistemit të ri, stafi i projektit ofroi servera dhe pajisje fundore/periferike për të përmirësuar infrastrukturën e TI-së të agjencisë dhe për të krijuar database-t e nevojshëm. Stafi i TI-së të APP-së bashkëpunoi me stafin e projektit për testimin e SPE-së gjatë fazave të ndryshme të përgatitjes së tij. Pas miratimit përfundimtar të SPE-së, stafi i projektit bashkëpunoi me APP-në për trainimin e më shumë se 1 000 zyrtarëve të prokurimit, magjistratëve, dhe operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ri.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE: ZYRA E AVOKATIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Për përmbushjen e kërkesave të donatorit për një strukturë praktike të mjeteve ligjore të prokurimit bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe të BE-së, qeveria, me Ligjin e Prokurimit Publik, krijoi Zyrën e Avokatit të Prokurimeve (ZAP). ZAP ka përgjegjësi dyfishe për (i) shqyrtimin e ankimeve që kanë të bëjnë me prokurimin dhe rekomandimin e veprimeve ligjore për zgjidhjen e ankimit, dhe (ii) kontrollin e ecurisë së sistemit të prokurimit.

Në fund të vitit 2007, qeveria emëroi punonjësit dhe rinovoi zyrën e ZAP-it. Stafi i projektit lëvroi mobiljet dhe paisjet e zyrës, përgatiti dhe instaloi sinjalistikën, përgatiti procedurat standarte për përpunimin e ankimeve, dhe trainoi inspektorët për përdorimin e tyre. Punonjësit e ZAP-it u trainuan gjithashtu për marrëdhëniet me publikun, përdorimin e SPE-së për shqyrtimin dhe analizat statistikore, dhe etikën e prokurimit.

INFORMIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT: DORËZIMI I ANKESAVE

Si agjenci krejt e re që funksionon sipas një koncepti të ri, ZAP-kishte nevojë për një fushatë

REZULTATE KRYESORE

- Miratimi i paketës së plotë të dokumenteve standarte të prokurimit dhe i rregulloreve për zbatimin e Ligjit të ri të Prokurimit Publik
- Të gjitha njoftimet e prokurimit dhe dokumentet e tenderimit mund të shkarkohen nga faqja e internetit
- Të gjitha ministritë përdorin sistemin e prokurimit elektronik
- Gjatë 10 muajve të parë të 2008 73 tendera u realizuan me sistemin elektronik te prokurimit, me vlerë totale $29 milionë
- Avokati i prokurimit përpunoi më shumë se 200 ankime
- Më shumë se 1 000 punonjës prokurimi dhe operatorë ekonomikë u trainuan për përdorimin e SPE-së
- U krijuan dy Qendra për Ndihmën Teknike të Prokurimit
- Mesatarisht 6.16 ofertues për tender që nga qershor 2008, me shume se 100 shoqeri ne muaj dërgojne ofërten e tyre nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

informimi për ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut për ekzistencën dhe shërbimet e saj. Në dhjetor 2007, projekti përgatiti dhe transmetoi në gjithë vendin një reklamë televizive për shpjegimin e rolit të ZAP dhe krijimin e imazhit të saj si një organizatë e pavarur që lufton për të drejtat e tenderuesve.

Fushata ishte e suksesshme dhe arriti rezultatet e dëshiruara për rritjen e vetëdijes së publikut për mjetet e reja ligjore, gjë që provohet nga numri në rritje i dorëzimit të ankimeve. Sipas sondazhit mbi Impaktin në Biznes 2008 rezulton që 73 përqind e bizneseve që kanë marrë pjesë në tenderime gjate tre viteve të fundit janë në dijeni të ekzistencës së ZAP.

Gjatë 10 muajve të parë të veprimtarisë së saj (nëntor 2007 – gusht 2008), ZAP mori 267 ankime prokurimi, nga të cilat 262 janë shqyrtuar. Agjencia e Prokurimit Publik ndoqi rekomandimet e ZAP në afërsisht 90 përqind të të gjithë rasteve në të cilat Agjencia ka marrë vendimin pas marrjes së rekomandinmeve të ZAP-it.

Stafi i projektit bashkëpunoi me ZAP për përgatitjen e raportit të saj të parë vjetor për Kuvendin, paraqitur nga Avokati i Prokurimeve në maj 2008. Raporti mbuloi periudhën e dy muajve të parë të veprimtarisë së ZAP, nëntor-dhjetor 2007, gjatë së cilës u shqyrtuan 38 ankime. Raporti paraqiti disa raste kur APP-ja nuk kishte zbatuar ligjin ose procedurat e saj.

QËNDRUESHMËRIA: NDËRTIMI I KAPACITETEVE TË SEKTORIT PRIVAT PËR PROKURIMIN ELEKTRONIK

Strategjia e stafit të projektit për zbatimin e qeverisjes elektronike u bazua në parimin e fuqizimit të bizneseve dhe qytetarëve. Në prokurimin publik, iu dha rëndësi e veçantë rritjes së njohurive, aftësive dhe profesionalizmit të punonjësve të sektorit privat që i shesin qeverisë mallra dhe shërbime. Gjatë gjithë vitit të dytë të projektit u organizuan trainime gjithëpërfshirëse për operatorët ekonomikë për përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik. Më shumë se 500 punonjës të shoqërive që i shesin qeverisë morën pjesë në këto trainime dy ditore dhe u pajisën paraprakisht me udhëzime rreth tenderave elektronikë në të cilët shoqëritë e tyre kishin planifikuar të merrnin pjesë.

Përveç kësaj, stafi përgatiti një kurs të prokurimit publik në nivel masteri pranë Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës. Kursi i ndarë në 12 sesione u pilotua në fillim të vitit 2008 me instruktorë ndërkombëtarë. 24 studentë, shumica avokatë dhe ekonomistë, përfunduan kursin, kaluan provimin, dhe u pajisën me çertifikata.

Për sigurimin e vazhdimësisë së asistencës teknike për shoqëritë në përdorimin e sistemit të prokurimit elektronik pas përfundimit të projektit, grupi pajisi dhe trainoi Njësitë e Asistencës Teknike të Prokurimit pranë dhomave shqiptare dhe ameri-

kane të tregtisë. Këto organizata kanë kapacitet të ndihmojnë ofertuesit e rinj kundrejt pagesës.

REZULTATET E MBËSHTETJES SË PROKURIMIT PUBLIK

Sistemi i prokurimit elektronik u miratua përfundimisht në mars 2008. Gjatë 5 muajve pas miratimit, 20 agjenci të qeverisë qendrore dhe vendore nxorën njoftime për më shumë se 200 prokurime elektronike, me vlerë më shumë se 1 000 milionë dollarë. Që nga fillimi i korrikut 2008, numri mesatar i prokurimeve të realizuara nëpërmjet prokurimit elektronik shkon mbi 20 në muaj.

Autoritetet kontraktore që kanë përdorur sistemin e prokurimit janë shprehur mjaft të kënaqur me mënyrën se si funksionon sistemi, dhe shumë prej tyre po i drejtohen prokurimit elektronik, duke e kthyer atë në procedurën e tyre standarte.

Monitorimi i jashtëm i ecurisë së sistemit të prokurimit elektronik ka treguar një rritje të dukshme të besueshmërisë dhe pjesëmarrjes në sistem. Që me miratimin e sistemit në mars 2008, më shumë se 300 shoqëri kanë dërguar elektronikisht një apo më shumë oferta. Numri i shoqërive qe dergon oferta në menyre elektronike ka ardhur duke u rritur ndjeshëm nga muaji në muaj, duke filluar me 2 shoqëri në mars 2008 dhe arritur në 159 shoqëri ne korrik 2008.

Me rritjen e besimit dhe pjesëmarrjes, teknologjia e re e prokurimit është duke u shndërruar me ritme të shpejta në një standart. Sipas Raportit të Impaktit të Biznesit për vitin 2008, 63 përqind e bizneseve nën studim, që kanë si qëllim të marrin pjesë në një tender përgjatë 12 muajve të ardhshëm e "mirëpresin së tepërmi" dorëzimin e dokumentave të tenderit online, dhe këto biznese e cilësojnë faqen e internetit të APP-së si burimin më të preferuar të tyre për të marrë informacion. Faqja e internetit e APP-së dhe Buletini Online i Njoftimeve të Prokurimit vazhdojnë të cilësohen si burimet më të përdorura të informacionit për tenderat dhe procedurat e prokurimit, përkatësisht me 63 dhe 31 përqind.

Më specifikisht, për bizneset e lokalizuara në Tiranë, faqja e internetit e APP-së ka qenë burimi më i përdorur (68%), ndërsa për bizneset që gjenden jashtë Tiranës, faqja e internetit të APP-së dhe vizitat në institucionet qeveritare janë cituar si burimet parësore, me 46% secili. Përdorimi i faqes së internetit të APP-së ka ardhur në rritje, nga 46% në vitin 2007 në 68% në vitin 2008.

Sipas studimit, 73 përqind e bizneseve janë në dijeni të ekzistencës së Zyrës së Avokatit të Prokurimit Publik. Mundësia për korrigjim të rasteve abuzive në fushën e prokurimit e ka rritur së tepërmi besimin e publikut tek sistemi.

Pjesëmarrja në rritje e bizneseve ka pasur si pasojë kursime në shpenzimet e qeverisë, rezultat ky që është në pajtim me teorinë mikro-ekonomike, sipas të cilës, konkurenca e rritur do të thotë çmime më të ulëta për t'u paguar.

Studimet empirike mbi prokurimin me konkurencë në SHBA përgjatë viteve, dhe në veçanti puna e Prof. George Stigler, kanë treguar se rritja e numrit të ofertuesve mund të gjenerojë kursime thelbësore për buxhetin e qeverisë. Një pjesë e këtyre kursimeve realizohen me shtimin e një ofertuesi të dytë, dhe deri kur arrin një numër prej 20 ofertuesish, përfitimet vijnë gjithnjë e më në rritje, pasi marrëveshjet e fshehta bëhen tepër jo-praktike në atë nivel konkurence.

Deri tani, analizat paraprake të shpalljes së fituesve në mënyrë elektronike në Shqipëri e konfirmojnë këtë rezultat. Numri mesatar i ofertuesve në tenderat elektronikë ka ardhur në rritje në mënyrë të vazhdueshme, që nga prezantimi i tyre, duke arritur një mesatare prej afërsisht 7 ofertues në muajin Shtator. Kursimet kundrejt vlerave të buxhetuara kanë ardhur në rritje, me rritjen e numrit të ofertuesve, duke arritur një shifër prej 15-20% për prokurimet elektronike, me një pjesëmarrje të 6 ose më shumë ofertuesve. Kursimet mesatare për 58 shpalljet e prokurimit elektronik deri më sot kanë arritur në 15%. Kurse, në rastet kur qeveria ka nxjerrë njoftime për prokurim duke përdorur proçesin në formë shkresore (procedurën manuale), numri mesatar i ofertave për çdo tender ka qenë 2.5, dhe kjo mesatare nuk ka pësuar ndryshim thelbësor gjatë vitit 2008. Më shumë se 75% e këtyre ofertave në formë shkresore kishin pjesëmarrjen e vetëm 2 ofertuesve, gjë që do të thotë se marrëveshja e fshehtë është shumë e mundshme. Kursimet mesatare kundrejt shumave të buxhetuara në prokurimin manual është 6-8%.

Duke pasur këto rezultate dramatike, Kryeministri shpalli në Shtator 2008 se ai do të kërkojë ndryshimin legjislativ të LPP, ku të kërkohet përdorimi 100% i prokurimit elektronik nga institucionet e qeverisjes qëndrore. Gjithashtu, ai u bëri thirrje edhe organeve të qeverisjes vendore dhe komunave të përdorin sistemin.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / EDURA MUHEDINI

Aplikimet e bizneseve përpunohen me shpejtësi përmes proçesit të regjistrimit të biznesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë. Tashmë i njohur si një institucion efikas dhe i organizuar, Qendra Kombëtare e Regjistrimit u krijua në shtator të vitit 2007, vetëm një vit pas fillimit të Projektit të Marrëveshjes së Pragut për Sfidën e Mijëvjeçarit. Meqenëse regjistrimi në QKR përfshin në mënyrë automatike dhe regjistrimin në organet tatimore, ai zgjeron bazën tatimore, e cila do të gjenerojë të ardhura shtesë, duke e ndihmuar në këtë mënyrë Qeverinë Shqiptare të ruajë normën e tatimeve në nivelin aktual, ndërkohë që kërkesat ndaj qeverisë rriten.

KREU PESË

REGJISTRIMI I BIZNESIT

Mjaft qeveri anembanë botës kanë krijuar procedura të thjeshta, të pakushtueshme dhe të shpejta të regjistrimit të biznesit në përpjekje për nxitjen e bizneseve të reja dhe të investimeve. Shqipëria zgjodhi konceptin e regjistrimit me një ndalesë (one-stop shop) për regjistrimin e biznesit si mënyrën më të mirë në dispozicion, falë gjendjes së teknologjisë në Shqipëri në atë kohë. Raporti "Të bësh biznes në Europën Juglindore" për vitin 2008 e portretizon Shqipërinë si "reformatore ambicioze …që po shkurton kohën dhe shpenzimet për fillimin e bizneseve". Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) zëvendësoi një proçes arkaik dhe të frangmentarizuar të regjistrimit tregtar nëpërmjet proçesit të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e Tiranës dhe gjykatat në rrethe, pasuar nga regjistrime shtesë në organet tatimore, organet e sigurimeve shoqërore dhe shëndëtesore, dhe bashki. Sipas procedurës së vjetër për regjistrimin e një biznesi duheshin mesatarisht 47 ditë.

Sistemi i ri kërkon paraqitjen e kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve mbështetëse në një nga sportelet e regjistrimit, pavarësisht vendit ku zhvillohet biznesi ose ku jeton pronari i biznesit. Kërkuesi dorëzon kërkesën për regjistrim brenda 30 minutash dhe të nesërmen merr çertifikatën e regjistrimit. Gjatë vitit të parë të veprimtarisë në Tiranë dhe në 11 lokale vendore, QKR përpunoi më shumë se 93 000 kërkesa, ndër të cilat 19 000 ishin regjistrime të bizneseve të reja. Publiku mund ti gjejë të gjitha të dhënat për regjistrimin e biznesit në faqen e internetit të QKR-së.

Aktualisht, bizneset mund t'i dorëzojnë elektronikisht kërkesat për regjistrim por duhet të shkojnë më pas në sportelet

e regjistrimit për të provuar identitetin e tyre dhe për të nënshkruar kërkesat. Pas krijimit të sistemit elektronik të kartës kombëtare të identitetit, regjistrimi i biznesit do të kryhet plotësisht elektronikisht, ashtu si kryhet aktualisht në disa vende të botës.

REFORMA LIGJORE DHE RREGULLATORE: LIGJI I QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

Vështirësia më serioze për t'u kapërcyer nga stafi i projektit për krijimin e QKR-së ishte afati i ngjeshur. Suksesi i reformës do të varej nga hapja brenda vitit e mjediseve kryesore të regjistrimit. Vënia e shpejtë në funksionim e QKR–së do të mundësonte dhënien e ndihmës nga projekti për një vit të tërë si edhe mbështetjen që regjistrimi elektronik i biznesit do t'i jepte funksionimit të qeverisjes elektronike në administratën tatimore dhe prokurimin publik. Plani i përgatitur nga KSM-ja dhe USAID-i u bazua në premisën që, deri në fillimin e projektit, (i) legjislacioni për krijimin e QKR-së do të ishte miratuar dhe (ii) qeveria

UDHËZUES PËR PUNONJËSIT E QKR MBI PROÇESIN E REGJISTRIMIT



REZULTATE KRYESORE

- Janë përpunuar 93,000 kërkesa
- Janë regjistruar afërsisht 19,000 biznese të reja
- Regjistrimi për një ditë bëhet në 12 qendra regjistrimi
- Regjistri tregtar është bërë elektronikisht i disponueshëm për publikun
- 95 përqind e komunitetit të biznesit i informuar rreth QKR
- 90 përqind e përdoruesve janë të kënaqur

do të kishte identifikuar dhe rinovuar mjediset për Qendrën.

Si ndodhi në fakt, puna filloi tamam kur qeveria miratoi një dokument lidhur me konceptin e regjistrimit me një ndalesë, përgatitur me fonde të veçanta të USAID-it. Para ndërmarrjes së punës për zbatimin e kësaj politike, stafi i projektit duhej të përgatiste legjislacionin për krijimin e QKR-së dhe të nxiste miratimin e përshpejtuar të tij. Përgatitja e legjislacionit u realizua me nënkontraktorë lokalë, organizata shqiptare që kishte qënë përfshirë në draftimin apo diskutimin e dokumentit me politika për reformimin e sistemit të regjistrimit të biznesit në Shqipëri. Kuvendi e miratoi ligjin për QKR-në në 3 maj 2007. Periudha 7 mujore ishte kohë rekord për përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e këtij ligji të rëndësishëm, veçanërisht duke marrë në konsideratë faktin që gjatë janarit dhe shkurtit zyrtarët kryesorë të qeverisë dhe të legjislativit ishin të angazhuar në fushatën elektorale për zgjedhjet vendore.

Për të mos humbur kohë stafi përgatiti paralelisht si harmonizimin e ndryshimeve ashtu edhe aktet nënligjore për zbatimin e ligjit të ri. Të dyja paketat e dokumenteve u miratuan nga Këshilli i Ministrave brenda disa javësh pas miratimit të ligjit të QKR-së. Gjatë periudhës së përgatitjes së ligjit, projekti bashkëpunoi me zyrën e Kryeministrit për identifikimin e ambientit të përshtatshëm për selinë e QKR-së në Tiranë. Ata gjithashtu përgatitën dhe testuan software-in e regjistrimit.

Progresi i shpejtë i legjislacionit të QKR-së përfitoi nga bashkëpunimi i ngushtë me Ministrin e Ekonomisë, i cili organizoi diskutime me shoqatat e biznesit dhe organet e pushtetit vendor për t'u njohur me shqetësimet e tyre duke fituar kështu mbështetjen e tyre. Legjislacioni që rezultoi nga ky proçes përmban disa kompromise kryesore politike që sheshuan udhën për miratimin e tij, por duhet thënë që këto kompromise e kanë ngushtuar fushën e reformës dhe komplikuar zbatimin e saj. Ndërmjet dispozitave më të rëndësishme janë:

- Përjashtimi i organizatave jo-qeveritare nga mbulimi prej QKR-së. Ato vazhdojnë të regjistrohen më vete me gjykatat dhe organet tatimore.
- Angazhimi për të hapur sportele shërbimi në të 29 bashkitë ku më parë gjykatat ofronin shërbime regjistrimi.
- Regjistrimi në sistemin e ri të bizneseve të regjistruara ne organet tatimore duke përdorur numrat e tyre ekzistues të identifikimit tatimor, dhe pa bërë kërkesë për ri-regjistrim ose përditësim të informacionit të tyre të regjistrimit.

NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE: QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

Pas miratimit të ligjit të QKR-së, stafi i projektit, brenda 12 javësh, duhej të projektonte dhe ndërtonte ndërtesën e re, të blinte pajisjet dhe orenditë, të instalonte

INTERVISTË
Në Shërbim të Rritjes Ekonomike

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / KATHY CAMP

Ismail Bardhi e riregjistroi biznesin e tij pasi Qendra Kombëtare e Regjistrimit e Shqipërisë e kishte reduktuar periudhën e regjistrimit, mesatarisht, nga 47 në 1 ditë.

Në 2007-n, Ismail Bardhi mendoi ta zgjeronte biznesin e tij të frigoriferimit me përfshirjen e njësive të lëvizshme për transportin e ushqimeve të freskëta. Por duke qenë se do t'i duhej dhe ta riregjistronte biznesin e tij, ai po e shtynte dita ditës fillimit e procedurave. Kur e kishte regjistruar fillimisht biznesin e tij në vitin 1997, i kishte marrë më shumë se një muaj dhe i kishte kushtuar afërsisht 12.000 lekë (150 dollarë) për të paguar avokatin. I ishte dashur, gjithashtu, që të shkonte dhe në gjykatë dhe te zyra e tatimeve për t'u pajisur me numrin e tatimpaguesit.

Në vitin 2008, Z. Bardhi mësoi për krijimin e Qendrës së re Kombëtare të Regjistrimit (QKR) nga Projekti i Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, i administruar nga.

USAID dhe i financuar nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit. "Më thanë se e vetmja gjë që duhej të bëja, ishte hartimi i një vendimi në emër të të gjithë ortakëve të shoqërisë dhe paraqitja e tij te personat e autorizuar", shprehet ai. Proçesi i transformuar i regjistrimit në QKR e ka reduktuar periudhën e regjistrimit, mesatarisht, nga 47 ditë në 1 ditë.

Në mes të prillit, Z. Bardhi bëri gati dokumentet e kërkuara dhe 100 lekë për të paguar tarifën e shërbimit dhe shkoi në zyrën qendrore të QKR-së në Tiranë. "Ishte një atmosferë shumë mikpritëse", thotë ai. "Personat që të presin, janë gjithnjë të buzëqeshur dhe të pyesin me se mund të të shërbejnë".

Z. Bardhi theksoi gjithashtu se profesionalizmi në sjellje dhe vëmendja ndaj klientit kanë eliminuar favoritizmat që mund të ndodhin në mjedise të cilat funksionojnë në mënyrë më

informale. Ndryshe nga sa ndodhte në të kaluarën, shërbimi nuk varej nga marrëdhëniet personale, humori i punonjësit apo pazare të tjera. "Për mua ishte e rëndësishme që në mjediset e QKR-së të gjithë njerëzit trajtoheshin njësoj", thotë ai. "Secili merrte një numër dhe shërbehej kur i vinte radha. Me këtë mënyrë të re, çdo njeri është njësoj i rëndësishëm".

“ Ka lezet të shkosh në QKR sepse ndihesh i mirëpritur nga punonjësit. Punonjësit janë shumë të sjellshëm, komunikues dhe të gjendur. Vetëm arsyeja e trokitjes në zyrat e qeverisë është stresuese. Por ndihesh mirë kur shikon dikë që të buzëqesh, të drejtohet me njerzillëk dhe të ofron ndihmë. Kështu të shkrin gjaku dhe kënaqesh kur mbaron punë me lehtësi.”

— PRONAR BIZNESI

“Më pëlqen më shumë tani se puna është e organizuar në bazë të marrëdhënieve me publikun. Nuk ke pse t’i vish para prapa, ose t’i ofrosh kafe punonjësit tatimor që të trajtohesh me njerzillëk.”

— PRONAR BIZNESI

software-in e ri, të krijonte bazën e të dhënave duke përdorur të dhënat kryesore tatimore të mbajtura nga DPT-ja për bizneset, të trainonte punonjësit e QKR-së për përdorimin e software-it të ri, të transferonte dokumentet ekzistuese të regjistrimit nga gjykatat anembanë Shqipërisë në selinë e QKR-së në Tiranë, dhe të informonte publikun lidhur me qendrën e re të regjistrimit. Të gjitha këto detyra u përmbushën në kohë rekord, në sajë të përpjekjeve të stafit të projektit dhe të nënkontraktorëve shqiptarë dhe në bashkëpunim të ngushtë me stafin e agjencive qeveritare homologe.

INFORMIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT: REGJISTRIMI I BIZNESIT ME NJË NDALESË

Stafi i projektit kontraktoi dhe ngarkoi një shoqëri vendase për përgatitjen dhe zbatimin e fushatës së informimit për paraqitjen e QKR-së para komunitetit të biznesit. Fushata përdori artikuj dhe njoftime të shkruar të afishuar në ndërtesat e gjykatave tregtare për njoftimin e bizneseve për ndryshimin e vendit për dorëzimin e kërkesave. Një reklamë televizive shpjegoi avantazhet e proçesit të ri të regjistrimit. Reklama televizive gjeneroi aq shumë kërkesa sa transmetimi i saj u ndalua për dy muaj derisa QKR-ja të mund të zgjeronte kapacitetin.

REZULTATET E MBËSHTETJES SË REGJISTRIMIT TË BIZNESIT

Gjatë vitit të parë të punës në Tiranë dhe në 11 zyrat vendore, QKR-ja përpunoi më shumë se 93 000 kërkesa, prej të cilave 19 000 regjistrime biznesesh të reja. Më shumë se 90 përqind e aplikimeve u përpunuan brenda 24 orësh. Më shumë se 90 përqind e klientëve ishin të kënaqur me shërbimet e kryera.

Publiku mund të shohë elektronikisht të gjitha të dhënat e regjistrimit të biznesit nëpërmjet faqes së internetit të qendrës. DPT-ja dhe APP-ja janë të lidhura elektronikisht me QKR-në dhe shkëmbejnë të dhëna biznesi çdo ditë. Kjo gjë rrit transparencën në operacione, siguron marrjen e informacionit të besueshëm nga të dy institucionet e lartpërmendura, rrit mundësitë për zgjerimin e bazës tatimore, dhe pakëson ekonominë “hije”.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / AGIM DOBI

Stafi i Projektit duke biseduar me stafin e sherbimit të tatimpaguesve tek zyrat e reja të Qendrës së Shërbimit të Tatimpaguesit në DPT. Stafi i Projektit zhvilloi një program të ri të Menaxhimit të Marrëdhënieve me Klientët për të mbështetur përpunimin e të dhënave dhe funksionet e menaxhimit të departamentit dhe si rrjedhojë të përmirësojë shërbimin e tatimpaguesve në qendër.

KREU GJASHTË

PRAKTIKAT MË TË MIRA DHE MËSIMET E NXJERRA

FAKTORËT KYÇ TË SUKSESIT

Tre faktorë kryesorë bënë të mundur arritjet e projektit. Dhe të tre keta faktorë kanë të bëjnë me bashkëpunimin strategjik me homologët e qeverisë shqiptare. Së pari, qeveria tregoi këmbëngulje dhe angazhim të lartë në arritjen e objektivave të projektit. Së dyti, qeveria ndërmori politika të reja, krijoi institucione të reja, dhe riorientoi institucionet ekzistuese drejt kryerjes efiçiente të shërbimeve publike. Së treti, qeveria e vuri theksin në përdorimin e TI-së për përmirësimin e transparencës dhe efiçiencës së shërbimeve publike.

ZBATIMI I LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT NËPËRMJET QEVERISJES ELEKTRONIKE: MËSIMET E NXJERRA

Politikat dhe strategjitë në nivel të lartë për projektin u ndërtuan në projektin e USAID-it, të hartuar sipas PPV-së. Roli i stafit të projektit ishte të propozonte strategjinë dhe taktikat zbatuese dhe të konsultohej me USAID-in nëpërmjet planifikimit të punës dhe proçesit të shqyrtimit. Stafi gjithshtu duhej t'i përshtatej afateve të ngjeshura dhe nevojave të veçanta e kufizimeve të programeve antikorrupsion. Më poshtë jepen disa nga tiparet më të rëndësishme të metodës së zbatimit.

- Planifiko dhe zbato iniciativat paralelisht. Reformat politike zakonisht marrin disa vjet për të arritur rezultatet e dëshiruara në qeveri. U bë e qartë që në fillim që, për arritjen e objektivave të tij, projekti nuk mund të ndiqte modelin standart të rradhës së punës duke filluar me reformën legjislative të ndjekur nga reforma administrative, trainimi i nëpunësve civilë, informimi i publikut dhe trainimi i përdo-

ruesve. Përkundrazi, disa nga këto veprimtari u ndërmorën paralelisht.

- Guxo të rrezikosh me mënd në kokë. Kryerja e detyrave paralelisht kërkonte ndër-marrjen e disa hapave të rrezikshme të menduara mirë, veçanërisht në fushën e informimit të publikut. Për identifikimin e taktikave më të mira të zbatimit u përdorën eksperimente afat shkurtra dhe të përgatitur me kujdes. Kur njëra rrugë nuk jepte rezultatet e dëshiruara, stafi provonte një rrugë të re.

- Nxit kërkesën për përmirësimin e shërbimeve të publikut nëpërmjet fushatave informuese. Pasi publiku mësohet me shërbime të nivelit të lartë dhe kërkesat e tij rriten, reformat bëhen të pakthyeshme. Reklama televizive që njoftoi për

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / AGIM DOBI

Ndërtesa e mëparshme e DPT-së (majtas), me strukturën e saj më tradicionale është në kontrast të plotë me ndërtesën moderne të DPT-së (poshtë). Asistenca për përmirësimin e infrastrukturës së DPT-së për shërbimet e tatimpaguesve filloi në vitin e parë projektit, paralelisht me hartimin e ligjit për procedurat tatimore. Suksesi i dukshëm krijoi besueshmëri ndaj reformës tatimore, duke i dhënë një shtysë të mëtejshme nismës legjislative dhe duke fituar mbështetjen nga komuniteti i biznesit.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / EDLIRA MUHEDINI

regjistrimin me nje ndalesë u transmetua menjëherë pasi QKR-ja hapi dyert e ambienteve të saj. Gjatë tre muajve të parë – regjistrimi për një ditë ishte një përjashtim – disa aplikues pritën me javë. Ankesat e tyre filluan të shfaqen në shtyp, gjë që ushtroi presion mbi qeverinë për të shtuar burimet e nevojshme për ta bërë realitet regjistrimin për një ditë.

- Shfrytëzo afatet e vendosura për evenimente publike për përqëndrimin e vëmendjes në realizimin e detyrave të planit të punës. Ceremonitë e përurimit paraqesin një mundësi të shkëlqyer për të reklamuar ekzistencën e një shërbimi të ri. Stafi i projektit programoi fonde për organizimin me cilësi të lartë të ceremonive të përurimit për infrastrukturën e ndërtuar duke përfshirë objektet e reja për katër nga pesë agjencitë homologe. Duke e ditur që Kryeministri kishte rënë dakort për të folur në ceremonitë e përurimit krijoi mundësinë për të komunikuar me zyrtarë të lartë qeveritarë dhe motivoi të gjithë organizatorët për të respektuar afatet e realizimit të projektit.

- Testo sistemet gjerësisht dhe vazhdimisht me grupe të vogla përdoruesish të trainuar para vënies së tyre në përdorim dhe kontrollo për të përcaktuar kur dhe ku nevojitet ritrainim. Ndërsa ndërmarrja e hapave të rrezikshme ndihmon për të fuqizuar proçesin e reformës, dështimet spektakolare e dëmtojnë atë. Kur ishte e mundur, grupi u përpoq të minimizonte rrezikun nëpërmjet zbatimit në faza. Për shembull, para se t'u paraqiteshin mijra tatimpaguesve, modulet e deklarimit elektronik të tatimeve u testuan dhe rishikuan për gjashtë muaj me një grup të ngushtë tatimpaguesish që ishin të gatshëm për të shërbyer si subjekte testimi. Në mënyrë të ngjashme, pasi nuk mund të parashikoheshin të gjitha problemet që mund të dilnin, grupi i rezistoi presionit për t'i hapur menjëherë të gjitha sportelet e shërbimit të QKR-së në zonat e largëta, duke e kufizuar hapjen në dy zyra në muaj për të mësuar nga përvoja e secilës zyrë.

- Kombino ndihmën për përfitime të shumëfishta. Megjithëse nevojat për reformat në regjistrimin e biznesit, administratës tatimore dhe prokurimit publik shpesh ishin të ndryshme, u kursye kohë dhe burime duke kombinuar disa veprimtari, si ishte trainimi i shërbimeve për klientin.

- Transfero përgjegjësinë e iniciativave tek përfituesi sapo të krijohet mundësia dhe rezultatet të jenë të dukshme. Marrja e përgjegjësisë mbi vete nga homologu garanton vazhdimësinë. Për shembull, proçesi i pastrimit të të dhënave për të krijuar regjistrin tregtar elektronik iu dorëzua QKR-së sapo u kryen operacionet e krahasimit të të dhënave fillestare dhe u përcaktua fizibiliteti i metodologjisë.

- Përdor nënkontraktorë vendas kur është e mundur, dhe

INTERVISTË

Shkarkimi nga Interneti Pakëson Korrupsionin Tatimor



PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / KATHY CAMP

Ashtu si pronari i librarisë Ferhat Muhedini, një numër gjithnjë e më i madh biznesesh shqiptare i shkarkojnë formularët tatimorë nga interneti për të kursyer kohë dhe para, dhe për të eliminuar kërkesat e padëshirueshme për të "lyer rrotën".

Ferhat Muhedini thotë se ka tre fëmijë: një vajzë, një djalë dhe librarinë e tij. Në vitet 90, pasi zyrtarët komunistë, të cilëve po u shkiste pushteti nga duart, i dhanë fund kufizimeve të vëna për botimet, Muhedini së bashku me të jatin filluan të shesin libra në një kioskë në rrugë. Në vitin 2001 ai hapi Shtëpinë e Miqve të Librit. Njësoj si të bijën dhe të birin, Muhedini e mbron me fanatizëm librarinë e tij por deri pak kohë më parë ai ndihej në mëshirën e inspektorëve tatimorë.

Deri në prill 2008, tatimpaguesit e biznesit të vogël – që përfaqësojnë 75 përqind të të gjithë tatimpaguesve – duhej të shkonin çdo tre muaj tek inspektorët tatimorë të caktuar për ta për të marrë formularët e shtypur të nevojshëm për të paguar tatimet shqiptare. Pa këta formularë, bizneset nuk mund të zbatonin legjislacionin tatimor, dhe disa inspektorë tatimorë e shfrytëzonin këtë situatë në interes të tyre.

Në prill, Muhedini i shkarkoi për herë të parë formularët e tij tatimorë nga interneti. Kjo mundësi u vu në dispozicion nga Marrëveshja dy vjeçare Prag e Sfidës së Mijëvjeçarit ndërmjet Qeverisë Shqiptare (QSH) dhe KSM, e administruar nga USAID, dhe ka ndihmuar QSH për reformimin dhe modernizimin e procedurave të administratës tatimore, prokurimit publik dhe regjistrimit të biznesit nëpërmjet zgjidhjeve të TI dhe përmirësimeve legjislative. Në vend të zakonisht tre ditëve, Muhedinit iu deshën vetëm tre orë për përfundimin e procedurës: që nga shtypja deri tek pagesa.

"Është një ndryshim i paimagjinueshëm. Kur shkova në zyrën e tatimeve për firmosjen e formularit të borderosë nga inspektori tatimor, punonjësja më pyeti për llojin e biznesit tim. Nuk e kishte idenë. Nuk më pyeti për asgjë tjetër, dhe i gjithë komunikimi ishte i shpejtë dhe profesional. Ajo bëri punën e saj, unë timen, dhe me kaq çdo gjë mori fund."

"Me këtë regjim të ri", thotë Muhedini, "ka marrë fund stresi që mund të shkaktonte një inspektor tatimor i papërgjegjshëm. Përkundrazi, tani kam më shumë kohë për t'u marrë me biznesin tim dhe të mendoj në mënyrë krijuese për t'u ofruar më shumë shërbime klientëve të mi".

përdor prokurim konkurues për mallrat dhe shërbimet. Konkureca ofron shërbim me të mirë, ruan burimet, dhe ndihmon imazhin e projektit në komunitetin e biznesit vendas. Të gjitha pajisjet e TI-së, orenditë dhe shërbimet e ndërtimit për homologët u kryen me konkurencë. Kursimet e bëra në fondet e projektit bënë të mundur prokurimin e mallrave dhe shërbimeve shtesë.

- Mbaji donatorët dhe zbatuesit e tjerë të informuar në mënyrë që të shmangen dublimet. Koordinimi i përpjekjeve të donatorëve është thelbësor për të parandaluar humbjet, konfuzionin, dhe dobësimin e veprimtarive të projektit. Koordinimi periodik me BE-në rezultoi në asistencë më efektive nga donatorët për DPT-në dhe Doganat, APP-në dhe KESH-in.

- Eduko median si të formulojë objektivat dhe sukseset e projektit. Iniciativat antikorrupsion që kanë të bëjnë me politika publike janë komplekse, dhe shtypi ka nevojë të edukohet. Grupi trainoi median dhe nëpunësit e çështjeve publike të agjencive homologe për proçesin dhe objektivat e reformës.

- Siguro angazhimin për arritjen e objektivave në të gjitha nivelet e organizatave homologe të rëndësishme: Angazhimi i homologëve qeveritarë të nivelit të lartë është një hap i rëndësishëm për arritjen e rezultateve të ndjeshme për një periudhë të shkurtër kohe. Projekti bëri të mundur arritjen e ndryshimeve institucionale pikërisht për shkak të bashkëpunimit të ngushtë dhe angazhimit të zyrtarëve më të lartë qeveritarë. Për sigurimin e mbështetjes sa më optimale të një projekti me afate të ngjeshura, personeli i homologëve në nivele të ndryshme duhet të përfshihet në hartimin e objektivave dhe aktiviteteve të projektit. Ka rëndësi të veçantë që punonjësit që do të angazhohen në mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e përditshme të kuptojnë objektivat e synuar dhe masat që duhen ndërmarrë për t'i arritur ato.

PROJEKTI I PRAGUT I SHQIPËRISË / AGIM DOBI

Stafi i TI i QKR **përditëson faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, që siguron akses falas për publikun në të dhënat e regjistrimit të biznesit. DPT dhe APP janë lidhur në formë elektronike me QKR dhe shkëmbejnë të dhënat e biznesit në bazë ditore, duke rritur në këtë mënyrë transparencën e veprimeve dhe duke reduktuar ekonominë informale. Prezantimi i të dhënave lehtësisht të aksesueshme nga faqet e internetit të institucioneve homologe përmirëson klimën e biznesit, tërheq investimet dhe stimulon kërkesën për përmirësime të mëtejshme në administratën publike.**

KREU SHTATË

REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

REKOMANDIME

1. *Mat progresin kundrejt objektivave antikorrupsion në terma të ecurisë së sistemit dhe ndryshimeve në sjellje dhe jo të ndryshimit të të menduarit.* Gjatë dy vjetëve, qeveria shqiptare ndryshoi rrënjësisht mënyrën e ndërveprimit me komunitetin e biznesit në tre fusha të rëndësishme.

   Ndërsa pjesa më e madhe e bizneseve janë në dijeni të reformave dhe kanë përfituar prej tyre në formën e shërbimeve të përmirësuara publike, ndryshimi i të perceptuarit zakonisht kërkon breza të tërë dhe jo disa vite.

   Për shkak se ndryshimi rrënjësor i opinionit publik në bazë të përvojës së ndryshuar kërkon një kohë të gjatë, projektet afatshkurtër duhet ta masin efektin e tyre me mënyrën e re të sjelljes dhe jo me perceptimin e sjelljeve. MCATA mati njohuritë dhe ndryshimin e të sjellurit nëpërmjet Sondazhit të Ndikimit të Biznesit, Sondazhit të Monitorimit të Ecurisë së QKR-së, dhe Sondazhit të Tatimeve në Internet, dhe nëpërmjet monitorimit të drejtpërdrejtë të përdorimit të shërbimeve elektronike të ofruara nga projekti. DPT-ja ka njohur publikisht kontributin e aktiviteteve të projektit të KSM-së në mbledhjen e 106 përqind të tatimeve të parashikuara për gjashtë mujorin e parë të vitit 2008.

2. *Vazhdo edukimin e publikut për të kërkuar më shumë dhe nxit kërkesën për ndryshimin e sistemit.* Plani i projektit dhe metoda e qeverisjes elektronike patën si premisë që forca lëvizëse e reformës do të ishte kërkesa në rritje e komunitetit të biznesit

SUKSESET E PROJEKTIT VLERËSOHEN NGA ZYRTARËT

"Përfitoj nga rasti për të shprehur mirënjohjen time më të thellë për tatimpaguesit amerikanë, qeverinë amerikane, dhe Programin e Marrëveshjes Prag të Sfidës së Mijëvjeçarit për ndihmën e çmuar që konsiston jo vetëm në kontributin financiar por edhe në futjen e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e regjistrimit të biznesit".

— SALI BERISHA, KRYEMINISTËR I SHQIPËRISË

"Për ne suksesi i [Qendrës Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit] është garanci që reforma aktuale – dhe sistemet e qeverisjes elektronike që e mbështesin atë - do të vazhdojnë edhe pas ndërprerjes së ndihmës sonë."

— ADMINISTRATORJA E USAID HENRIETTA H. FORE
NË CEREMONINË DEDIKUAR AKSHI-T, 19 MAJ 2008

për shërbime të përmirësuara. Nxitja e kërkesës dhe rritja e shpresave dhe standarteve zakonisht çojnë në përmirësimin e shërbimeve, kurse pajtimi me gjendjen zakonisht gjeneron rezultat të kundërt. Shërbimet më të mira çojnë në përmirësimin e klimës së biznesit, investime më të larta, dhe rritje ekonomike, që shoqërohet nga rritja e paprecedent në regjistrimin e bizneseve të reja pas krijimit të sistemeve të reja.

3. *Kryej monitorimin e ecurisë së shërbimeve elektronike nëpërmjet sondazheve në internet të përdoruesve.* Mënyra më e mirë për të mësuar nëse sistemet funksionojnë si duhet dhe nëse përdoruesit janë të kënaqur është t'u kërkosh mendimin menjëherë pas përdorimit të shërbimeve nga ana e tyre. Identifikimi dhe targetimi i përdoruesve aktualë është me rëndësi për vlerësimin e dobisë së shërbimeve elektronike.

   MCATA përdori intervista pas përdorimit të shërbimit për të matur ecurinë e sistemit dhe shkallën e kënaqësisë së përdoruesit në Sondazhin e Monitorimit të Ecurisë së QKR-së, dhe një sondazh në internet për të matur shkallën e kënaqësisë dhe për të diagnostikuar problemet në përdorimin e shërbimeve elektronike të tatimeve.

4. *Vendos tarifa të arsyeshme të përpunimit që mbulojnë koston e shërbimeve dhe fuqizojnë*

sektorin privat për të trainuar përdoruesit në kurse me pagesë. Qeveria ka burime të kufizuara financiare ndërkohë që duhet të plotësojë shumë kërkesa. Bizneset duhet të paguajnë për shërbimet e përmirësuara, dhe duhet të paguajnë për të mësuar si t'i përdorin më mirë këto shërbime. Nga Sondazhi i Ndikimit të Biznesit doli që bizneset janë të gatshëm për të paguar tarifa më të larta për shërbimet e ofruara nga QKR-ja. Tarifat aktualisht mbulojnë vetëm rreth 10 përqind të kostos operative të sistemit të QKR-së.

KONKLUZIONE

Shqipëria ka përmirësuar klimën e biznesit duke reformuar dhe modernizuar proçeset kryesore. Për më tepër, ajo ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për reduktimin e mundësive që ushqejnë korrupsionin dhe fitimin e besimit të qytetarëve, bizneseve dhe investitorëve të huaj.

Sistemet e automatizuara u ofrojnë pronarëve të bizneseve procedura më të thjeshta e më të shpejta për regjistrim, pagesat e tatimeve dhe për të konkuruar në tenderat qeveritare. Dymbëdhjetë sportele shërbimi mundësojnë regjistrimin e bizneseve me një ndalesë që kryhet brenda 24 orësh.

Dokumentet e prokurimit publik mund të merren pa pagesë në faqen përkatëse të internetit, dhe sistemi elektronik përmban kontrolle strikte që parandalojnë manipulimin e rezultateve të tenderave. Një agjenci e re shqyrton dhe merr vendime për ankimet lidhur me parregullsitë në proçesin e prokurimit publik. Bizneset mund t'i shkarkojnë elektronikisht të gjithë formularët tatimorë dhe t'i paguajnë tatimet elektronikisht.

Një agjenci e re qeveritare mirëmban dhe mbështet TI-në, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve elektronike. Për shkak të angazhimit dhe bashkëpunimit ndërmjet qeverisë shqiptare, Korporatës së Sfidës së Mjëvjeçarit dhe USAID-it, Shqipëria ka arritur rezultate të ndjeshme në luftën kundër korrupsionit.

SHTOJCË A

TABELA RAPORTUESE E REZULTAVE FINALE

Indikatorët e Performancës		Objektiva	Vlera fillestare	Viti Fiskal	2007				2008			
				Tre-Mujori	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
PIR 1.0 Ulja e korrupsionit në administratën dhe politikën tatimore												
Indikatori 1.0.1	Përqindja e firmave që pohojnë se ryshfeti është i zakonshëm në mbledhjen e taksave	35%	42%	Objektiva	42%	-	-	-	40%	37%	36%	35%
				Aktual	42%	-	-	-	26%	N/A	N/A	19%[1]
KRA 1.1 Sqarimi i ligjeve tatimore, rregulloreve dhe udhëzuesit shpjegues												
Indikatori 1.1.1	Numri i ligjeve per taksat, legjislacioni dytesor dhe rregulloret e rishikuara, rihartuara dhe/ose te amenduara	29	0	Objektiva	5	10	15	24	26	27	28	29
				Aktual	6	10	19	20	20	20	22	31
Indikatori 1.1.2	Cilësia e udhëzuesit shpjegues të taksave të ofruar nga projekti	95%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	N/A	95%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	99%	99%[2]
KRA 1.2 Masat parandaluese për të zvogëluar korrupsionin e institucionalizuar												
Indikatori 1.2.1	Përqindja e llogarive të taksapaguesve të disponuara elektronikisht	100%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	50%	100%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	41%	100%
Indikatori 1.2.2	Numri i nevojshëm i vizitave në zyrat e taksave	0	4	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	0
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	1
Indikatori 1.2.3	Përqindja e deklaratave të dorëzuara elektronikisht nga taksapaguesit e mëdhenj të Tiranës	15%	0%	Objektiva	5%	5%	5%	5%	15%	15%	15%	15%
				Aktual	0%	-	-	-	15%	20%	33%	47%[3]
Indikatori 1.2.4	Të ardhurat tatimore nga zyra e taksapaguesve të mëdhenj si përqindje e totalit të të ardhurave tatimore	50%	30%	Objektiva	30%	30%	30%	30%	50%	50%	50%	50%
				Aktual	40%	49%	51%	51%	51%	49%	50%	50%[4]

Indikatorët e Performancës		Objektiva	Vlera fillestare	Viti Fiskal	2007				2008			
				Tre-Mujori	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
KRA 1.3 Rritja e përgjegjësisë për gabimet në mbledhjen e taksave												
Indikatori 1.3.1	Koha mesatare per te pergatitur, aplikua dhe paguar(ose ndaluar) 3 tipet e medha te taksave	200 hours	240 hours	Objektiva	-	-	-	220	-	-	-	200
				Aktual	-	-	-	240	-	-	-	190
Indikatori 1.3.2	Niveli i kënaqësisë së Taksapaguesve me shërbimin e taksave	70%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	70%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	89%[5]
Indikatori 1.3.3	Numri mesatar i pagesave tatimore për cdo firmë në vit	25	53	Objektiva	53	-	-	-	52	52	25	25
				Aktual	N/A	-	-	-	44	-	-	36
Indikatori 1.3.4[6]	Krijimi i Gjykatës së Taksave	1	0	Objektiva	0	-	-	-	1	1	1	1
				Aktual	0	-	-	-	-	-	-	-
KRA 1.4 Rritja e informimi të taksapaguesve për strukturën e re ligjore dhe pajtueshmërinë me të												
Indikatori 1.4.1	Numri i bizneseve të konsultuar paraprakisht për finalizimin e ligjit të ri të taksave	110	0	Objektiva	-	-	-	50	110	-	-	-
				Aktual	-	-	-	51	111	-	-	-
Indikatori 1.4.2	Përqindja e taksapaguesve të informuar për procedurat e reja	75%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	55%	75%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	N/A	95%
PIR 2.0 Rritja e transparencës në prokurimin publik dhe ulja e korrupsionit												
Indikatori 2.0.1	Vlera e 'dhuratës' që duhet dhënë për të siguruar një kontratë qeveritare si përqindje e vlerës së gjithë kontratës	2%	6.15%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	2%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	1%
Indikatori 2.0.2	Përqindja e firmave që konfirmojnë se ryshfeti është i zakonshëm për marrjen e kontratave qeveritare	35%	42%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	35%
				Aktual	-	-	-	-	26%	-	-	17%
Indikatori 2.0.3	Përqindja e prokurimeve të përfunduara elektronikisht	2.5%	0%	Objektiva	-	-	-	-	1%	1.5%	2%	2.5%
				Aktual	0%	-	-	-	-	-	0.2%	2.1%

Indikatorët e Performancës		Objektiva	Vlera fillestare	Viti Fiskal	2007				2008			
				Tre-Mujori	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
Indikatori 1.4.2	Përqindja e taksapaguesve të informuar për procedurat e reja	75%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	55%	75%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	N/A	95%[7]
PIR 2.0 Rritja e transparencës në prokurimin publik dhe ulja e korrupsionit												
Indikatori 2.0.1	Vlera e 'dhuratës' që duhet dhënë për të siguruar një kontratë qeveritare si përqindje e vlerës së gjithë kontratës	2%	6.15%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	2%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	1%
Indikatori 2.0.2	Përqindja e firmave që konfirmojnë se ryshfeti është i zakonshëm për marrjen e kontratave qeveritare	35%	42%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	35%
				Aktual	-	-	-	-	26%	-	-	17%[8]
Indikatori 2.0.3	Përqindja e prokurimeve të përfunduara elektronikisht	2.5%	0%	Objektiva	-	-	-	-	1%	1.5%	2%	2.5%
				Aktual	0%	-	-	-	-	-	0.2%	2.1%[9]
Indikatori 2.0.4	Përqindja e prokurimeve publike si procedurë e hapur	60%	35%	Objektiva	N/A	N/A	N/A	N/A	45%	50%	55%	60%
				Aktual	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	36%	50%	54%[10]
Indikatori 2.0.5	Ulje në koston e prokurimeve të qeverisë	-20%	0%	Objektiva	0%	-	-	-5%	-5%	-10%	-15%	-20%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	- 15%
KRA 2.1 Zhvillimi dhe implementimi i rregullores dhe udhëzuesit shpjegues												
Indikatori 2.1.1	Numri i rregulloreve të prokurimit të hartuara, rishikuara dhe/ose rivleresuara	8	0	Objektiva	0	0	0	0	2	3	4	8
				Aktual	3	5	6	6	7	7	7	7
Indikatori 2.1.2	Cilësia e udhëzuesit shpjegues ofruar nga projekti	95%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	95%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	93%	95%[11]
KRA 2.2 Insitucionalizimi i kapacitetit të APP për një proçes transparent												
Indikatori 2.2.1	Përqindja e buletinëve të prokurimit publik të publikuar elektronikisht	100%	0%	Objektiva	12.5%	25%	37.5%	50%	62.5%	75%	87.5%	100%
				Aktual	-	13%	25%	38%	51%	63%	76%	100%

Indikatorët e Performancës		Objektiva	Vlera fillestare	Viti Fiskal	2007				2008			
				Tre-Mujori	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
Indikatori 2.2.2	Përqindja e stafit të APP e trajnuar për politikat e reja të prokurimit	100%	0%	Objektiva	-	92%	92%	92%	100%	100%	100%	100%
				Aktual	-	92%	92%	92%	92%	92%	100%	100%
Indikatori 2.2.3	Përqindja e stafit të APP e trajnuar në integrimin me TI dhe përdorimin e proçesit të e-prokurimit	100%	0%	Objektiva	-	30%	40%	50%	75%	100%	100%	100%
				Aktual	-	32%	48%	48%	60%	60%	80%	100%
Indikatori 2.2.4	Numri i oficerëve të prokurimeve dhe nëpunësve publik të trajnuar	2,000	0	Objektiva	-	400	400	700	1,000	1,500	1,700	2,000
				Aktual	-	411	411	618	714	767	850	898
KRA 2.3 Fuqizimi i biznesit për të bërë APP përgjegjëse në proçesin e prokurimit												
Indikatori 2.3.1	Numri i operatorëve ekononomik të trajnuar për ligjin e ri të prokurimit elektronik dhe rregulloret	600	0	Objektiva	-	0	0	300	350	400	500	600
				Aktual	-	97	97	97	193	204	420	505
KRA 2.4 Rritja e informimit të sektorit privat për strukturën e re ligjore dhe pajtueshmërinë me të.												
Indikatori 2.4.1	Përqindja e bizneseve e informuar për sistemin e prokurimit elektronik system	40%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	40%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	89%[12]
Indikatori 2.4.2	Përqindja e bizneseve që është e informuar mbi zyrën e re të Avokatit të Prokurimeve	40%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	40%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	73%[13]
PIR 3.0 Ulja e korrupsionit në proçesin e regjistrimit të biznesit												
Indikatori 3.0.1	Përqindja e bizneseve që paguan ryshfet per tu regjistruar	5%	19%	Objektiva	-	-	-	15%	-	-	-	5%
				Aktual	19%	-	-	-	-	-	-	0%
KRA 3.1 Zhvillimi dhe implementimi i strukturës së re ligjore për regjistrimin e biznesit dhe udhëzuesit shpjegues												
Indikatori 3.1.1	Numri i ligjeve të lidhura me regjistrin tregtar të rishikuara, hartuara, dhe/ose amenduara	29	0	Objektiva	0	0	0	29	29	29	29	29
				Aktual	25	29	29	29	29	29	29	29
Indikatori 3.1.2[14]	Niveli i njohurive të stafit të QKR sic është raportuar nga klientët e QKR	90%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	90%	-
				Aktual	-	-	-	-	-	-	89%	-

Indikatorët e Performancës		Objektiva	Vlera fillestare	Viti Fiskal	2007				2008			
				Tre-Mujori	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
KRA 3.2 Ngritja dhe bërja operacionale e Qendrës Kombëtare të Biznesit												
Indikatori 3.2.1	Numri i bizneseve te reja te regjistruara ne QKR	15,000	0	Objektiva	-	-	-	500	2,650	6,650	14,000	15,000
				Aktual	-	-	-	516	3,711	12,098	16,713	19,334
Indikatori 3.2.2	Volumi total i shërbimeve kryer nga QKR	32,000	0	Objektiva	-	-	-	700	3,100	5,500	30,000	32,000
				Aktual	-	-	-	518	5,766	21,747	28,278	42,015
Indikatori 3.2.3	Numri i aplikimeve për ndryshime të aplikuara nga QKR	5,000	0	Objektiva	0	-	-	1,000	1,000	2,000	3,000	5,000
				Aktual	0	-	-	231	1,495	5,738	7,914	11,685
KRA 3.3 Efektshmëria e proçesit të regjistrimit të biznesit dhe integrimit me TI												
Indikatori 3.3.1	Numri i ditëve për të regjistruar një biznes	1	47	Objektiva	-	-	-	37	-	-	-	1
				Aktual	-	-	-	1	-	-	-	1
Indikatori 3.3.2	Përqindja e regjistrimimeve të bizneseve të përfunduara brenda një dite	86%	0%	Objektiva	-	-	-	-	40%	80%	85%	86%
				Aktual	-	-	-	-	39%	84%	85%	85%
Indikatori 3.3.3	Kostoja totale e regjistrimit si perqindje e te ardhurave per kapital	13%	31%	Objektiva	25%	-	-	-	13%	-	-	13%
				Aktual	31%	-	-	-	6%	-	-	6%[15]
KRA 3.4 Rritja e informimit dhe pelqimit të sektorit privat për strukturën e re ligjore												
Indikatori 3.4.1	Numri i vizitorëve në faqen e Internetit të QKR	2,000	0	Objektiva	N/A	N/A	N/A	1,000	1,250	1,500	1,750	2,000
				Aktual	N/A	N/A	N/A	250	300	1,817	5,448	9,052[16]
Indikatori 3.4.2	Përqindja e bizneseve të informuara mbi ligjet dhe procedurat e reja	75%	0%	Objektiva	-	-	-	-	-	-	-	75%
				Aktual	-	-	-	-	-	-	-	96%[17]

[1] 56 përgjigje që pohojnë se ryshfeti është i shpeshtë nga 297 pwrgjigje ne total.

[2] 1,027 njerëz që vlerësojnë trajnimin së paku me "mirë" nga 1,043 pjesëmarrës në total.

[3] 767 deklarata të dorëzuara elektronikisht nga 1,641 deklarata në total.

[4] Për periudhën Janar – Gusht 2008: shuma totale e të ardhurave tatimore nga GDT = 95,586,796 Lek dhe shuma totale nga të ardhurat tatimore të takspaguesve të mëdhenj = 48,004,207 Lek.

[5] 133 veta e vleresuan te pakten "të kënaqshëm" nivelin e shërbimit të taksave nga 149 përgjigje në total.

[6] Kjo kërkesë është hequr nga plani i punës me miratimin e USAID pasi Ministria e Drejtësisë ka hartuar legjislacion per te ngritur gjykaten administrative me funksion te taksave ne nje projekt në vazdhim.

[7] 143 biznese konfirmuan informimin e tyre për procedurat e reja nga 150 përgjigje në total.

[8] 20 biznese u përgjigjën që ryshfeti është i shpeshtë, nga nje total prej 121 përgjigjesh.

[9] 73 prokurime elektronike nga 3,478 prokurime në total.

[10] Numri total i procedurave (fitues) = 3,395; Procedurë e hapur (fitues) = 1,832.

[11] 414 pjesëmarrës e vlerësuan trajnimim me të paktën "mirë" nga 437 pjesëmarrës në total.

[12] 96 përgjigje nga 108 konfirmojnë informimim mbi Sistemin e Prokurimit Elektronik.

[13] 79 përgjigje nga 108 konfirmojnë informimim mbi zyrën e Avokatit të Prokurimeve.

[14] 1,065 pjesëmarrës nga 1,200 në total vlerësuan nivelin e njohurive me të paktën "mirë"

[15] E llogaritur si vijon: Të ardhurat për Person = 2,980 Dollarë Amerikanë (burimi: Raporti i Bankës Botërore, 2006); Kosto Totale = Kosto e Regjistrimit (1 Euro=1.4 Dollarë Amerikanë) + kosto të tjera për dokumentacionin ligjor që nevojitet për regjistrim (162.5 Dollarë Amerikanë).

[16] Përfshin vetëm numrin unik të vizitorëve.

[17] 286 pjesëmarrës nga 297 në total konfirmuan informimin e tyre mbi ligjet dhe procedurat e reja.

TREGUES I PËRMBAJTJES SË CD UDHËZUESE

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I MPSMSH. . . . . ANEKSI A

KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR. . . . . .ANEKSI B

NDËRTIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE. . . . . ANEKSI C

INFORMIMI DHE NDËRGJEGJËSIMI I PUBLIKUT . . . . . ANEKSI D



U.S. Agency for International Development
1300 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20523
Tel: (202) 712-0000
Fax: (202) 216-3524
www.usaid.gov